

Kadaj-Bujupi: Shtesat e fëmijëve ka mundësi të rriten në vitet e ardhshme



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, KA TAKUAR NË PARIS LIDERËT BOTËRORË, DONALD TRUMP, ANGELA MERKEL, VLADIMIR PUTIN, EMMANUEL MACRON DHE REXHEP TAJIP ERDOGAN | FAQE 4-5

THAÇI TAKON LIDERËT BOTËRORË

Pas presidentit amerikan Donald Trump, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë mbështetje për dialogun Kosovë - Serbi edhe nga presidenti i Rusisë, Vladimir Putin. Presidenti Thaçi ka bërë me dije se në takimin që ka zhvilluar me presidentin e federatës ruse, ky i fundit ka bërë të qartë se do ta mbështesë çdo marrëveshje paqësore që arrihet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Për fazën finale të dialogut me Serbinë, gjatë qëndrimit në Paris, presidenti Thaçi ka marrë mbështetje edhe nga kancelarja gjermane Angela Merkel, presidenti francez Emmanuel Macron dhe presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan



AKTUALE

A JANË MË TË RREZIKSHËM SABOTUESIT E PAQES APO CUBAT E PRITËS?! F. 12



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

ROLI I GRUAS NË LIRINË DHE PAVARËSINË E KOSOVËS F. 12



PhD Salihe SALIHU

VETËVENDOSJA NË PRISHTINË KËRKON TË NDALEN NDËRTIMET PA LEJE F. 8

EKONOMI

ROLI I NDËRMARRËSISË DHE INOVACIONIT, FAKTOR KYÇ NË ZHVILLIMIN EKONOMIK F. 9

REÇICA NIS KONSULTIMET PUBLIKE PËR KONCEPT-DOKUMENTIN E REFORMËS PENSIONALE F. 9

KULTURË

REFLEKSIONE PËR LIBRIN '69 GRA' TË ARBËR AHMETAJT F. 13



Nga Dr. Irena GJONI

SPORT

CHALLANDESI: MOSKUALIFIKIMI ËSHTË DËSHTIM, POR JO FUNDI I BOTËS F. 16

Kuvendi me urgjencë sot do t'i shqyrtojë projektligjet e agjendës evropiane | FAQE 3



FLET PËR "EPOKËN E RE", HASAN UKËHAXHAJ (2)

Pas marsit të '98-s detyra ime kryesore ishte t'i bind mërgimtarët që ta ndihmojnë UÇK-në | FAQE 6-7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Nga janari i vitit të ardhshëm bëhet unifikimi doganor Kosovë - Shqipëri

Në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive, e cila do të mbahet më 26 nëntor në Pejë, pritet të nënshkruhet marrëveshja për unifikimin doganor në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, e cila do të fillojë së zbatuari nga janari i vitit të ardhshëm



PRISHTINË, 12 NËNTOR - Marrëveshja për unifikimin doganor në mes të Kosovës dhe Shqipërisë pritet të nënshkruhet më 26 nëntor, në mbledhjen e përbashkët të këtyre dy qeverive që do të mbahet në Pejë, kurse do të fillojë së zbatuari nga janari i vitit të ardhshëm, thonë zyrtarë të Qeverisë së Kosovës.

Lulzim Rafuna, këshilltar i ministrit të Financave në Qeverinë e Kosovës, njëherësh këshilltar i kryeministrit të Shqipërisë për dogana dhe tatime, tha për "Radion Evropa e Lirë" se për këtë çështje të dy qeveritë janë në fazat e fundit të harmonizimit të dokumentacioneve të nevojshme për mallrat që qarkullojnë në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Ai tregon se me këtë marrëveshje planifikohet që të mos kërkohen dokumente të panevojshme, por të njihen në mënyrë reciproke dokumentet e të dyja shteteve. "Qëllimi është që të harmonizohen të gjitha këto procedura, të eliminohet kontrolli i dyfishtë që kemi pasur dhe e kemi ende deri në hyrjen në fuqi të këtij protokoll. Paralelisht, jemi duke punuar që Zyrën Doganore në Durrës ta avancojmë dhe të harmonizohet komplet me këtë protokoll

dhe të harmonizohet me procedurat e reja që do të aplikohen në vendkalimin doganor Morinë - Vermicë", tha Rafuna. Për ta lehtësuar transportin e mallrave në mes dy shteteve, në muajin korrik është përfunduar pika e përbashkët kufitare Morinë - Vermicë që lidh Kosovën me Shqipërinë. Me këtë projekt, që është financuar nga Bashkimi Evropian me më shumë se një milion euro, është bërë modernizimi i pajisjeve. Edhe njohës të kësaj çështjeje konsiderojnë se bizneset e të dyja shteteve do të përfitojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje.

Ish-drejtori i Doganës, Naim Huruglica, njëherësh ligjërues për çështjet doganore dhe transportin ndërkombëtar, tha për "Radion Evropa e Lirë" se çdo shkurtim i procedurave të pritjes në kufi, ul koston e të bërit biznes. "Në mes të Kosovës dhe Shqipërisë është unifikim i procedurave në kuptimin e orareve, formave, punës në një objekt të përbashkët, për të mos pasur nevojë të ushtrohen dy kontrolle, pasi mund të bëhet një kontroll i vetëm me ekipe të përbashkëta. Kjo është një fazë më e avancuar sesa të kesh kontroll plotësisht të veçantë

doganor", thekson Huruglica. "Kjo lehtëson punën sepse shkurtimi i kohës dhe procedurave ul koston e transportit, ul koston e të bërit biznes dhe automatikisht kjo e bën fuqinë tonë konkurruese pasi jemi në gjendje të dalim më lirë në treg me ato produkte që i kemi", thotë Huruglica.

Për përfaqësues të komunitetit të biznesit, një vendim i tillë do ta lehtësonte qarkullimin e mallrave të dy shteteve dhe do ta rriste mundësinë e investimeve të përbashkëta.

Agim Shahini, kryetar i Aleancës Kosovare të Biznesit, thotë se me këtë vendim do të konkretizohen në praktikë marrëveshjet në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. "Do

të pranohen doganat e dy vendeve, do të unifikohet kontrolli i përbashkët dhe shumë produkte që do të vijnë në Portin e Durrësit apo të Vlorës do të kenë mundësi të doganohen atje, pastaj drejt do të vijnë në Kosovë. Kjo është risi që deri më tani nuk ka ekzistuar", tha Shahini.

Ndryshe, marrëdhëniet dypalëshe që prej shpalljes së pavarësisë së Kosovës me shtetin e Shqipërisë janë rritur nga viti në vit. Kjo vërehet edhe me rritjen e vëllimit të shkëmbimeve tregtare në mes të këtyre dy shteteve. Sipas të dhënave zyrtare, vlera e importit të produkteve nga Shqipëria në vitin 2008 ka qenë rreth 60 milionë

euro përderisa në vitin e kaluar kjo shifër është rritur në 151 milionë euro.

Ndërkaq, vlera e produkteve të Kosovës që eksportohen në Shqipëri në vitin 2008 ka qenë mbi 21 milionë euro dhe në vitin 2017 vlera e këtyre produkteve ka arritur në 60 milionë euro. Madje, institucionet e ndryshme të Shqipërisë dhe të Kosovës kanë vendosur një bashkëpunim reciprok. Këto marrëdhënie janë konkretizuar me firmosjen e mbi 50 marrëveshjeve. Megjithatë, vlerësohet se këto dy shtete gjatë shkëmbimeve tregtare disa herë kanë hasur në vështirësi dhe konsiderohet se nuk kanë arritur të kenë marrëdhënie tregtare në nivel të kënaqshëm.

Rama zbulon detaje për bazën ajrore të NATO-s në Kuçovë



TIRANË, 12 NËNTOR - Në lidhje me kthimin e bazës së Kuçovës në ambient për dislokimin e forcave ajrore të NATO-s, të hënën reagoi edhe kryeministri Edi Rama. Sipas Ramës, investimi në fjalë kap shifrën e mbi 50 milionë euro, ndërsa do të përkthehet në më shumë vende pune dhe zhvillim ekonomik për zonën. "Morëm angazhimin e NATO-s për të investuar në këtë bazë mbi 50 milionë euro. Faktikisht është një investim që do ta mundësojë transformimin e kësaj hapësire ushtarake të NATO-s që do të shër-

bejësi bazë esaj për stërvitje ajrore. Kjo do të jetë edhe bazë kombëtare për forcat ajrore të Shqipërisë, duke krijuar mundësinë e një standardi të ri të forcave të armatosura në këtë sektor të posaçëm.

Ky investim do të krijojë mundësi të reja, kundërtimi i një baze ajrore të teknologjisë së fundit do të thotë më shumë punësim dhe ekonomi në një reze të caktuar rreth saj. Ma ha mendja se është në vëmendjen e të gjithëve se ne jemi angazhuar shumë seriozisht për t'i përbushur objektivat e përcak-

tuara në çdo vend në kuadër të aleancës. Buxheti i 2019-s për mbrojtjen është pasqyrim i saktë. Ky buxhet arrin në 22 miliardë lekë dhe përbën një rritje prej 10% krahasuar me këtë vit", tha Rama. Ai njoftoi se pas Kuçovës këtë status do të marrë edhe baza ajrore e Farkës. "Ne e kemi çuar përpara bashkëpunimin me ShBA-në lidhur me modernizimin e kapaciteteve ushtarake. Pas modernizimit të Bazës Ushtarake të Kuçovës ne do ta modernizojmë edhe bazën ajrore të Farkës", tha Rama.

Kuvendi me urgjencë sot do t'i shqyrtojë projektligjet e agjendës evropiane

Deputetët e Kuvendit të Kosovës sot (e martë), në një seancë të jashtëzakonshme, do t'i shqyrtojnë projektligjet që kanë të bëjnë me agjendën evropiane dhe procesin e liberalizimit të vizave. Vendimi për këtë seancë është marrë nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e së hënës, me kërkesë të kryeministrit Ramush Haradinaj. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka bërë me dije se ka një urgjencë kohore të veprimit për ta çuar përpara agjendën evropiane të Kosovës



**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Sot (e martë) deputetët e Kuvendit të Kosovës në ora 10:00 do të mbledhen në një seancë të jashtëzakonshme për t'i shqyrtuar dhe miratuar projektligjet që kanë të bëjnë me agjendën evropiane dhe procesin e liberalizimit të vizave. Përkatësisht Kodi Penal, Projektligji për konfiskimin e pasurisë të fituar me vepër penale, Projektligji për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe Projektligji për përgjegjësinë disiplinore janë katër projektligjet që kërkojnë prioritet për miratim në Kuvendin e Kosovës. Vendimi për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme është marrë në mbledhjen e së hënës të Kryesisë së Kuvendit, me kërkesë të kryeministrit Ramush Haradinaj. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka thënë se ka një urgjencë kohore të veprimit për ta çuar përpara agjendën evropiane të Kosovës. Në mënyrë që të mos vonohet

vendi në përafrimin me BE-në, ai ka theksuar se Kosova duhet t'i shtojë përpjekjet për të unifikuar agjendën për integrim. Për t'i koordinuar hapat rreth ndërtimit të konsensusit kombëtar për agjendën evropiane, paraditen e së hënës kryeministri Ramush Haradinaj, i shoqëruar nga ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha dhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, është takuar me anëtarët e Komisionit për Legjislacion të Kuvendit të Kosovës. Për t'i çuar përpara pakot ligjore nga fusha e sundimit të ligjit që lidhen me zbatimin e MSA-së dhe me impakt në liberalizimin e vizave, Haradinaj ka kërkuar përshtetimin e punës në të gjitha hallkat e sistemit. "Jemi në kohë bukur të ngushtë para rezultateve të nevojshme tashmë të duhura për të hyrë Kosova në agjendën e liberalizimit të vizave. Kemi kaluar me sukses falë punës suaj dhe të gjithë të tjerëve etapat e deritashme, ato të Komisionit e të

Parlamentit, por jemi prapë në një urgjencë kohore të veprimit. Dhe, sikurse e dini, disa ligje janë në evidencë të palëve në mënyrë që të quhet si avancim", ka deklaruar Haradinaj. Ai ka kërkuar nga anëtarët e Komisionit për Legjislacion që projektligjet që janë të ndërlidhura me liberalizimin e vizave, MSA-në dhe Agjendën e Reformave Evropiane, të përshpejtohen në mënyrë që të shkohet në një seancë plenare në një afat sa më të shkurtër kohor dhe Kosova të ketë gjasa të hyrjes në agjendën e Këshillit të BE-së për çështjen e vizave. Krahas Kodit Penal, Projektligjit për konfiskimin e pasurisë të fituar me vepër penale, Projektligjit për mbrojtjen e sin-

jalizuesve dhe Projektligjit për përgjegjësinë disiplinore, prioritet për miratim në Kuvendin e Kosovës kërkojnë edhe Projektligji për Gjykatat, Projektligji për Këshillin Gjyqësor dhe Projektligji për Këshillin Prokurorial. Ndërsa kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë të hënën, pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, se të gjitha kriteret janë plotësuar nga ana e institucioneve të Kosovës për liberalizimin e vizave dhe se pret që edhe Franca, si shtet që ka shprehur skepticizëm lidhur me këtë proces, të reflektojë pasi, sipas Veselit, asnjë shtet i BE-së nuk do të ketë probleme me refugjatë nga Kosova nëse liberalizohen vizat. "Refugjatë kosovarë në Francë dhe në të

gjitha shtetet e BE-së ka shumë pak. Kosova ka arritur larg progresit të cilin e ka Gjeorgjia, Ukraina, Moldavia apo Shqipëria. Thjesht, qytetarët duhet tanë të lëvizin lirshëm. Nuk duhet të rritet skepticizmi, por të rritet reflektimi i vendeve të BE-së që t'i respektojnë qytetarët tanë", ka deklaruar Veseli, duke shtuar se në ditët në vijim liderët institucionalë do të realizojnë vizita lobuese në mënyrë që vendet anëtare të BE-së, sidomos ato që hezitojnë, të kenë një pasqyrë të saktë për Kosovën. Në këtë kontekst, ai ka bërë me dije se do të vizitojë Brukselin, në përpjekje për t'i bindur vendet anëtare të BE-së që të marrin një vendim pozitiv për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Kadaj-Bujupi: Shtesat e fëmijëve ka mundësi të rriten në vitet e ardhshme



PRISHTINË, 12 NËNTOR - Deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Donika Kadaj-Bujupi, që ka iniciuar miratimin e rezolutës për shtesat e fëmijëve, ka bërë me dije se kjo rezolutë do të fillojë të zbatohet nga viti 2019. Ajo ka thënë për gazetën "Epoka e re" se shtesat e fëmijëve ka mundësi të rriten në vitet e ardhshme me rritjen e buxhetit. Sipas Kadaj-Bujupit, është shumë e rëndësishme që kjo çështje është mirëpritur nga qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët për herë të parë në Kosovën e pasluftës realizojnë

për fëmijët e tyre një të drejtë universale. "Jemi shumë të bindur që kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, do ta zbatojë rezolutën brenda vitit 2019 siç edhe kërkohet në pikën 2 të kësaj rezolute. Është vetëm një nismë e cila ka mundësi të rritet përgjatë viteve me rritjen e buxhetit. Është shumë e rëndësishme që kjo çështje është mirëpritur nga qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët për herë të parë në Kosovën e pasluftës realizojnë për fëmijët e tyre një të drejtë universale. Nëse ju kujtohet, pensionet i filluam me 24 euro në muaj, kurse tani janë mbi 90 euro

pas vendimit të fundit të marrë nga kryeministri Haradinaj, me ç'rast pensionet bazë janë rritur për 15 për qind, kurse pensionet kontributdhënëse për 10 për qind", ka deklaruar Kadaj-Bujupi. Ajo ka treguar se me anë të kësaj rezolute Kuvendi i kërkon Qeverisë që sa më parë ta hartojë dhe zbatojë legjislacionin për ndarjen e shtesave për fëmijë. Po ashtu, bazuar në këtë rezolutë, shumica e shtesave për fëmijët do të kategorizohet duke marrë parasysh kriteret përkatëse, duke përfshirë të hyrat familjare, punësimin e prindërve dhe moshën e fëmijëve.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka takuar në Paris liderët botërorë, Donald Trump, Angela Merkel, Vladimir Putin, Emman

THAÇI TAKON LID

Pas presidentit amerikan Donald Trump, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë mbështetje për dialogun Kosovë - Serbi edhe nga presidenti i Ruisë, Vladimir Putin. Presidenti Thaçi ka bërë me dije se në takimin që ka zhvilluar me presidentin e federatës ruse, ky i fundit ka bërë të qartë se do ta mbështesë çdo marrëveshje paqësore që arrihet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Për fazën finale të dialogut me Serbinë, gjatë qëndrimit në Paris, presidenti Thaçi ka marrë mbështetje edhe nga kancelarja gjermane Angela Merkel, presidenti francez Emmanuel Macron dhe presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan



EPOKA E RE **Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka takuar liderët më të fuqishëm botërorë në Paris, në ceremoninë e organizuar me rastin e 100-vjetorit të mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Pas takimeve me udhëheqësit perëndimorë, në këtë ceremoni presidenti Thaçi ka takuar edhe presidentin rus Vladimir Putin, nga i cili ka marrë mbështetje për dialogun Kosovë - Serbi. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka bërë me dije se presidenti rus do të përkrahë çdo marrëveshje përfundimtare në mes të këtyre dy shteteve. "Në Paris e takova për herë të parë presidentin e Ruisë, Vladimir Putinin. Dialogu për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe mundësia e arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse ligjore dhe obliguese ishin temat kryesore të bisedës sonë. Lidhur me këtë çështje, presidenti Putin ishte i qartë: 'Në rast se ju (Kosovë - Serbi) arrini marrëveshje paqësore, Rusia do ta mbështesë këtë marrëveshje'", ka shkruar Thaçi. Po në Paris presidenti i Kosovës është takuar edhe me presidentin amerikan Donald Trump, kancelaren gjermane

Angela Merkel, presidentin francez Emmanuel Macron dhe presidentin turk Rexhep Tajip Erdogan, nga të cilët ka marrë mbështetjen për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Sipas presidentit Thaçi, presidenti Trump mbështet 100 për qind marrëveshjen Kosovë - Serbi. "Mbrëmë (të shtunën) kam pasur një takim të rëndësishëm me presidentin e ShBA-së,

Donald Trump. Ai shprehu 100 për qind mbështetje për arritjen e marrëveshjes ligjorë të detyrueshme në mes të Kosovës dhe Serbisë. I jam mirënjohës për mbështetjen e tij dhe të Amerikës", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Twitter". Përkrahje për dialogun presidenti ka marrë edhe nga kancelarja gjermane Angela

Merkel. "Kisha një bisedë të shkurtër edhe me kancelaren gjermane Angela Merkel në Paris. Ne diskutuam për mundësinë për të arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse paqësore për Kosovën dhe Serbinë. Ne të dy u pajtuam se mbështetja e Gjermanisë është vendimtare për këtë marrëveshje dhe anëtarësimin tonë në BE", ka treguar Thaçi pas

takimit me Merkelin. Ndërsa presidentin francez Emmanuel Macron, Thaçi e ka falënderuar për nderimin që i ka bërë Kosovës në këtë ceremoni, duke e bërë të barabartë me të gjitha shtetet e tjera pjesëmarrëse. Në fakt, protokollin francez në këtë ceremoni e kishte privilegjuar presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, duke e vendosur në

Emel Macron dhe Rexhep Tajip Erdogan

ERËT BOTËRORË



prekura nga konflikti. Gazetat publikuan fotografi të liderëve duke shikuar ceremonitë, përfshirë Vuçiqin dhe presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. "Mund të imagjinoni se si jam ndjerë", cituan mediat serbe Vuçiqin.

Së bashku me presidentin Thaçi në Paris ishte edhe zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, i cili është takuar me sekretarin amerikan të shtetit, Mike Pompeo, këshilltarin për siguri kombëtare të presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, John Bolton,

ndihmësekretarin amerikan të shtetit për Evropë dhe Euro-Azi, Wess Mitchell, ministrin e Jashtëm të Francës, Jean-Yves Le Drian, ministrin e Jashtëm të Turqisë, Mevlut Çavusoglu, si dhe homologë dhe përfaqësues të tjerë të lartë nga më shumë se 50 shtete të botës. "Në ceremoni, gjatë drekës dhe në margjina të kësaj ngjarje, kisha mundësi të takohesha me shumë homologë të mi e liderë botërorë, përfshirë Sekretarin e Shtetit Pompeo, të cilin e ftova për vizitë dhe i cili shprehu gatishmërinë që të vijë në Kosovë", është shprehur Pacolli. Ai ka thënë se paqja

dhe siguria në botë është prioritet i aleatëve tanë, ndërsa zotimi i Kosovës është i fuqishëm për t'i kontribuar kësaj sigurie. "Ky është përcaktimi ynë primar dhe në funksion të kësaj është edhe angazhimi ynë për t'u bërë anëtar i Interpolit dhe mekanizmave të tjerë të sigurisë ndërkombëtare. Kjo fundjavë shënoi një sukses të jashtëzakonshëm të diplomacisë sonë dhe jam i lumtur që këtë sukses do ta vazhdojë me energji maksimale, i koncentruar tash në sfidën e radhës në Interpol", është shprehur zëvendëskryeministri Pacolli.

Ministri Bytyqi: Personave me aftësi të kufizuara do t'u ofrojmë arsim cilësor

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ka raportuar të hënën para Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut lidhur me zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2023, ku ishin të pranishëm edhe përfaqësues të shoqatave dhe asociacioneve të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara. Me këtë rast, ai ka thënë se MASHT-i, bazuar në masat të cilat janë përcaktuar

në planin kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, i ka adresuar të gjitha obligimet që dalin për Ministrinë e Arsimit dhe janë marrë hapa konkretë që këto të realizohen. "Fillimisht është plotësuar infrastruktura ligjore, e cila është në zbatim dhe janë hartuar edhe instrumentet e standardizuara për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me aftësi të kufizuara, i cili ka filluar të pilotohet në shtatë komuna me 14 shkolla në bashkëpunim me Universitetin e Padovës dhe atë të Bolonjës, projekt ky i cili do të zgjasë deri në qershor të vitit 2019. Janë hartuar edhe parametrat e financimit për

nxënësit me nevoja të veçanta dhe kjo do të ndikojë në rritjen e cilësisë së përkujdesjes së shoqërisë sonë për këta nxënës", ka deklaruar Bytyqi. Ai ka treguar se MASHT-i, në bashkëpunim me institucionin 'Pearson' të Anglisë, gjatë vitit 2017 ka përgatitur gjeneratën e parë prej 54 asistentëve për nxënësit me nevoja, ndërsa gjatë këtij muaji ka filluar përgatitja e gjeneratës së dytë prej 75 sosh për këtë çështje. Gjithashtu, ministri ka përmendur edhe faktin se me grandin specifik për vitin 2019 është planifikuar të punësohen 100 asistentë të cilët do të shpërndahen sipas kërkesave dhe nevojave të specifikuar nga komunitat, ndërsa në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit pritet të angazhohen edhe 100 studentë praktikantë. "Po ashtu, janë punësuar një numër i konsiderueshëm asistentësh dhe profesorësh që do të ndihmojnë në procesin e mësimnxënies për fëmijët me nevoja të veçanta, ku dhe janë formuar ekipet vlerësuese në 24 komuna dhe janë bërë trajnime adekuate në bashkëpunim me Forumin Kosovar dhe UNICEF-in. Gjithashtu, fola edhe për angazhime të tjera të MASHT-it në funksion të përmbushjes së obligimeve të përcaktuara në planin kombëtar për personat me aftësi të kufizuara dhe për të ofruar një arsim cilësor për të gjithë", ka deklaruar ministri Bytyqi.



rendin e dytë të ulëseve, menjëherë prapa presidentit amerikan, presidentit francez, kancelares gjermane dhe presidentit rus. Mënyra se si Franca i kishte ulur liderët botërorë në ceremoninë me rastin 100-vjetorit të fundit të Luftës së Parë Botërore ka nxitur zemërim e protesta në Beograd dhe thirrje për sqarime nga Franca, ngaqë presidenti serb në këtë cere-

moni ishte vendosur në pjesën ku qëndronin edhe liderët e tjerë të rajonit.

Ndërkaq presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se është fyer nga trajtimi që i është bërë gjatë ceremonive për 100-vjetorin e fundit të Luftës së Parë Botërore në Francë.

Ceremonitë përkujtimore mbledhën në fundjavë në Paris liderë nga vende të shumta, të

Flet për "Epokën e re", Hasan Ukëhaxhaj (2)

Pas marsit të '98-s detyra ime kryesore ishte

Profesori dhe veprimtari i çështjes kombëtare, Hasan Ukëhaxhaj, në pjesën e dytë të intervistës dhënë gazetës "Epoka e re", ka bërë me dije se pas marsit të '98-s detyra e tij kryesore ishte t'i bindë mërgimtarët që ta ndihmojnë UÇK-në. Në këtë intervistë Ukëhaxhaj flet edhe për aktivitetin e vet në Gjermani në kuadër të PLK-së dhe për kthimin në Kosovë në qershor të '99-s, kur ishte emëruar zëvendësministër i Arsimit në Qeverinë e Përkohshme të drejtuar atëkohë nga Hashim Thaçi si dhe për dorëheqjen e tij nga kjo pozitë



EPOKA E RE Mal QORRAJ

asnjë moment rreth dërdëllitjeve të tyre.

PRISHTINË, 12 NËNTOR -

"Epoka e re": Edhe një pyetje shitesë: Ç'konotacion kishin parullat e brohoritura?

Hasan Ukëhaxhaj: Prapë shkurtimisht mund të thuhet se trangu i tyre ishte kërkesa për Kosovën Republikë, të tjerat ishin degët që e justifikonin atë: me të parën kërkohej shkëputja e saj nga Serbia, e cila Kosovën e shfrytëzonte si koloni. Ky raport shprehej nëpërmjet parullës 'Trepça punon, Beogradi ndërton', pra një eksploatim deri në palcë. Ndërkaq, me të tretën, e me të tjerat nuk po vazhdoj, 'Jemi shqiptarë, s'jemi jugosllavë' shprehej kundërshtimi i vendosur i platformës, prapavija e së cilës ishte jo vetëm shoviniste, por edhe raciste. Nga 'letra' atë patën filluar ta jetësojnë përmes një demagogjie se gjoja ajo ishte një nismë e natyrës vullnetare e më vonë, kanë llogaritur 'programerët' e saj do ta akreditonin si të detyrueshme... S'është vështirë të kuptohet se me ç'stuhli do të përballëshin shqiptarët në një të ardhme të afërt. Ishte kjo një kopje që shovinistët serbë e morën nga perandoria e stepeve e cila qe përpjekur për ta krijuar 'kombin sovjetik'. Po ia bëj një pyetje vetes: Çka u arrit me demonstratat e vitit 1981: Levën kohezive antishqiptare me emrin 'bashkim-vëllazërim' aso pranverë shqiptarët e palosën në arkivol dhe e dërguan për Beograd. Pra, kurrë Serbia nuk e paqtoi më Kosovën. As Jugosllavia nuk arriti më kurrë të stabilizohet. Kurrë më Lëvizja ilegale nuk e ndërpreu veprimtarinë e vet derisa arriti ta formojë edhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Këto janë vetëm disa prej vlerave të pranverës së vitit 1981. Ata që mendojnë se demonstratat nuk ishin në të mirë të kauzës kombëtare më së miri është që të mos ndalem

"Epoka e re": A mund të na thoni diçka rreth veprimtarisë së Komitetit të Deçanit para dhe gjatë demonstratave?

Hasan Ukëhaxhaj: Aq sa është e mundur në suazat e një interviste. Në kuadër të Komitetit vepronte edhe grupi i të rinjve që ndryshe quhej Grupi i Shqiptonjave, në strukturën e të cilit nuk mungonin edhe veprimtarë që e kishin kapërcyer moshën e cekur. Veprimtaria e tyre kishte karakter krejtësisht praktik. Konkretisht shpërndarjen e materialit propagandistik, shkrimin e parullave dhe veprime të tjera të ngjashme. Këtu po e jap vetëm një të dhënë: gjatë vjeshtës së tetëdhjetës dhe në muajt janar e shkurt të vitit historik janë shpërndarë më se dyqind ekzemplarë të 'Lajmëtarit' anekënd Kosovës. Aktiviteti mori përmasa edhe më të mëdha pas 11 marsit, respektivisht pas 1 prillit. Edhe për këtë një të dhënë: Veprimtarët e Grupit Shqiptonja, përveç të tjerave që po i kapërcej, dy herë i kanë shpërndarë afishet anekënd fshatrave të Komunës së Deçanit, përmes të cilave populli thirrej për të dalë në demonstratë. Po ku të dilte? Edhe ekspertët ushtarakë e konsiderojnë konfiguracionin si një faktor të rëndësishëm që mund ta sjellë fitoren, përkatësisht humbjen e betejës. Pra, ku të dilnin? Në qendrën e vogël të Deçanit e cila, përveçse me policë, ishte e mbushur edhe me ushtri, meqë konsiderohej zonë ushtarake. Në ato rrethana nuk kishte mundësi të bashkoheshin as pesë veta. Meqë Komiteti i Deçanit ishte qendra e LNÇ-së në ato vite nuk do të ishte korrekte sikur ta kapërcejja veprimtarinë e Komitetit të Drenasit dhe të atij në formim e sipër në Mitrovicë. I pari pas 11 marsit e zhvilloi një veprimtari të lakmueshme e cila u kurorëzua me organizimin e demonstratës në qendër të

qytezës. E njëjta mund të thuhet për veprimtarët në Mitrovicë, madje edhe për celulën e Llapit. Veprimtaria nuk mund të mos e kishte koston që të kristalizohet në tri fazat e njohura: arrestimet, hetimet dhe gjykimet, të cilat janë hallakat e një zinxhiri që u 'rrah' në kullat e Pejës, Prishtinës dhe të Mitrovicës. Meqë s'më takon për të tjerët, po i kapërcej edhe të miat, por jo ato të Ismailit, i cili është përballur me vështirësitë më të mëdha të cilat i përballoi burrërisht. Të 'kallajisura' nga Gjykata Supreme rezultuan 12 vjet për Ismailin e ne të tjerët pas tij. Dënime të larta morën edhe anëtarët e Komitetit të Drenasit e të Mitrovicës.

"Epoka e re": Për vështirësitë në kazamatet e Jugosllavisë, do të na thoni diçka?

Hasan Ukëhaxhaj: Po e

përsëris, aq sa mund të thuhet në një intervistë. Pas gjashtë muajve para e pas gjykimit në burgun e Pejës, në një nga ditët e gjysmës së parë të nëntorit, se data e saktë nuk po më kujtohet, vetë të gjashtin më dërguan në burgun e Prishtinës. 'Transferimi' vazhdoi menjëherë për në ShNK të Nishit, tanimë të shoqëruar nga serbianët. Të tretën e dënimit e mbajta sikur shokët e tjerë që kishim dënime pak më të larta në repartin e izolimit. Pra, në '84-n u bashkova me të tjerët, atyre që na prisnin. Mal, për t'i përshkruar ato vite duhen faqe të tëra, prandaj po e ndërpres rrëfimin. As emra nuk përmenda, se janë shumë. Por nuk mund të mos e theksoj se harmonia në mes të shokëve ka qenë në shkallë të lakmueshme, prandaj po e shfrytëzoj rastin që përmes kësaj interviste t'i

falënderoj publikisht të gjithë ata të rinj, kundruall moshës sime, për konsideratën e të tjerave që po i kapërcej. Vështirësi kemi pasur, por ato përballtoheshin edhe më lehtë kur ishim të gjithë bashkë: edhe kur dënoheshim me izolim, edhe kur bënim grevë urie etj. Më 22 apo 23 prill të '90-s na komunikuan mua dhe Hysen Gegës se pas një ore do të jemi të lirë. Natyrisht se u habitëm, meqë nuk e pritnim. Na bashkuan me Kadri Llugaliun nga Llapi dhe Sylë Muajn nga Rugova në drejtorinë e burgut prej nga na përcillen përtej mureve. U nisëm për në stacionin e autobusit. Sa qesh befashuar kur m'u tha ajo që e ceka, edhe më tepër familja kur shkova në shtëpi.

"Epoka e re": Jeni liruar nga burgu në kohën kur Kosova

t'i bind mërgimtarët që ta ndihmojnë UÇK-në



përballej me shumë sfida. A patët vështirësi për t'u 'akomoduar' pas një dekade?

Hasan Ukëhaxhaj: Mal, edhe këtu shkurtimisht, ndoshta te bezdisa me këtë 'refren', por s'kam çfarë të bëj. Vështirësitë ishin të natyrës objektive, megjithatë, përveç rrethit familjar, ishin edhe shokët që kishin dalë më përpara nga burgu (Ismaili është liruar 6 muaj pas meje) më ndihmonin për t'u 'ambientuar'. Në verën e '90-s me Ramadan Shalën dy herë e kërkua bacën Adem, por nuk e gjetëm. Ndërkaq, në vjeshtën e vonë, pasi e kishte vizituar në fshatin Isniq një ish të burgosur, erdhi në Carrabreg bashkë me veprimtarin e shquar Ahmet Haxhiun. Pas një ore më tha se do ta vazhdojmë rrugën për në Glogjan, për ta vizituar Ismailin që sapo kishte dalë nga burgu, pastaj u nis për

në Gjakovë për t'i takuar bashkëveprimtarët e vjetër. Në pranverën e vitit '91, dy shokët të cilët i takova në Prishtinë, më thanë se baca Adem kishte pak punë me ty. Shkova dhe, siç e kishte zakon, menjëherë ma tha atë që e kishte planifikuar: ta formoj këshillin... për Komunën e Deçanit. Ia pranova propozimin pa kurrfarë hezitimi. Kur u ktheva, i thashë vëllait si me shaka 'vizita e bacës Adem po do me na dalë dardhë me bisht'. Kur ia sqarova se për çfarë ishte fjala, më tha: 'S'ke çka matesh, pas tij ose pas askujt'. Nuk është modeste, por po dua t'i dal hakut vëllait, ndonëse më duhet të kthehem në verën e vitit '81. Isha ende nën hetime. Kishte ardhur nga bjeshka dhe të autorizuarve ua kishte kërkuar një takim të shkurtër me mua. Ia kishin lejuar pas këmbënguljes së tij

dhe në prani të njërit, prej tyre më tha: 'Ti edhe këta që të kanë marrë, por tash po e di edhe unë, erdha me të thanë se për familjen, sa të jem gjallë, mos baj dert. Të tjerat i di ti vetë'.

Mal, edhe një episod nuk mund ta kapërcej. Është janari i '91-shit: shokët nga ana e Gjilanit i përkujtuam heronjtë e rënë afër Shtutgartit dhe nuk pat kurrfarë ndërhyrjesh nga ana e policisë. E organizuam edhe ne përvjetorin e rënies së tyre në një sallë kooperative në fshatin Isniq, se në Deçan ishte krejtësisht e pamundur. Pak para se ta përfundojmë tubimin, policia, e cila kishte ardhur me autoblanda, na dha ultimatumin ndërpriteni vetë ose jua ndërpresim ne. E zgjodhëm të parën, prandaj u larguam pa asnjë incident, por pas dy orësh më arrestuan në shtëpi. Në gjykatë më dënuan dy muaj me kusht, me akuzën për prishje të rendit dhe qetësisë publike. Deri në qershorin e '94-s edhe tri herë më kanë arrestuar për punën që e kryeva në kuadër të Këshillit për të Drejtat e Njeriut. U ktheva edhe te nxënësit nëpër shtëpitë - shkolla. Me kërkesën e mjedisit u ktheva edhe në politikë: në vjeshtën e '93-s u zgjodha anëtar i kryesisë së LDK-së për Degën e Deçanit. Mal, këto ishin tri fushat që u përpoqa 'të akomodohej' dhe besoj se ia pata arritur. Ndërkaq, kur s'e prisja, në qershorin e '94-s, më erdh një lajm shqetësues, por para se ta 'lexoj' një parantezë me katër pesë rreshta: nga Kosova qenë larguar disa prej shokëve: Xhavit Hoxha para '90-s; Ismaili, i cili ishte më i arsyeshmi, në verën e '91-shit; Jashari, pasi e dërrmoi policia dhe Dina, po ashtu. Tani po i kthehem lajmit: Isa Hasanmetaj, i vëllai i Avdullahut, më tha se policia, meqë nuk e gjeti në shtëpi, ia la thirrjen për t'u lajmëruar të nesërmen. Por ajo që ishte më kryesorja, ai kishte vendosur mos t'i përgjigjet. Në mbrëmje e biseduam me vëllanë dhe djemtë, që ishin atë natë në shtëpi, situatën e re. Pasi vendosëm që të largoheshim nga Kosova, ua kërkuam tri ditë dhe m'i dhanë. Ua mbylla notat nxënësve në prani të tyre, e thirra mbledhjen e Këshillit në të cilën e zgjodhëm nënkryetar Muhamet Haklajn. Pra, bacës Adem nuk ia lashë 'grigjën pa bari'... Dhe kryq e tërthor bjeshkëve tona, me gjithë djalin, Shkëlzenin, dolëm në Shqipëri e prej andej në Gjermani. Mal, ky është 'akomodimi' im dhe kataraktet me të cilat u përballa në ato katër vjet e dy muaj pasi që u ktheva nga burgu i Nishit në Kosovë.

"Epoka e re": Pyetja tjetër, mendoj e arsyeshme, 'akomodimi' në Gjermani.

Hasan Ukëhaxhaj: Së pari po them se procedurën ligjore autoritetet gjermane e përfunduan më shpejt sesa që mendoja në cilësinë e statusit të refugjtit politik. Ndërkaq, u 'kooptova' në LPK, me veprimtarët e së cilës mbaja kontakte në vitet e përshkruara më sipër. E kam udhëhequr nëndegën e saj në Gjermani, ndërkaq pas zgjedhjes anëtar i këshillit të përgjithshëm për degën jashtë vendit, i propozova këshillit të nëndegës, tanimë heroin Fehmi Lladrovcin, për të më zëvendësuar. Ai së pari nuk donte të ma pranonte dorëheqjen, por pas arsyetimit tim e më shumë për respektin, dhe kjo s'është modeste që po e them, nuk ma ktheu fjalën. Edhe më përpara, por pas marsit të '98-s, detyra ime kryesore ishte që t'i bindja mërgimtarët për ta ndihmuar UÇK-në, pjesën 'teknike' e kryenit të tjerët... Në qershorin e '99-s hyra në Kosovë për të marrë pjesë në mbledhjen e përgjithshme të LPK-së e cila brenda vendit mbahej pas shumë vitesh. U njoftova se isha emëruar zëvendësministër për Arsim e Kulturë në Qeverinë e Përkohshme, detyrë të cilën e kreu katër ditë dhe në mbrëmjen e kësaj të fundit ia paraqita gojarisht dorëheqjen kryeministrit Hashim Thaçi. Arsyet e dorëheqjes m'i kërkoi, por ato i kam për vete. U pajtuam dhe nuk u ndamë keq. Me fundin e qershorit të atij viti, hiq dekadën si profesor në Gjimnazin 'Vëllezërit Frashëri', kontributin tim njëzetvjeçar në fushën e veprimtarisë atdhetare për vendin e konsideroj të kryer.

"Epoka e re": Pasi thatë se e përfunduat punën atdhetare, a mund t'ia bëni të ditur opinionit kontributin tuaj në fushën e profesionit dhe kulturës në përgjithësi dhe çfarë do të presë lexuesi në të ardhmen nga penda juaj?

Hasan Ukëhaxhaj: E di se nga më erdhi pyetja, Mal, sepse para katër vjetësh ma botuat punimin për Jeronim e Radën me rastin e 200-vjetorit të lindjes së tij. Tani po vazhdoj: punimin e parë e kam shkruar me porosi të Jusuf Gërvallës, të cilën ma përcolli Ismail Haradinaj, për nr. 2 të 'Lajmëtarit'. Nuk kishte më shumë se një muaj ç'prej se E. Çabej kishte kaluar në përjetësi, prandaj punimi me titull 'Vdiq vigani i gjuhësisë shqiptare' është botuar në organin e përmendur me

pseudonimin 'Drini'. Pasi u lirova prej burgut e kam botuar punimin rreth 20 faqesh me titull 'Konferenca e Londrës dhe çështja shqiptare sot' në disa vazhdimë në 'Zërin e Kosovës', me pseudonimin 'Shpend Dukagjini'. Redaksisë së gazetës ia dërgonte veprimtari Ibish Neziri, i cili edhe vetë ishte ilegal në Kosovë. Kur u vendosa në Gjermani i kam botuar një varg punimesh në organin e organizatës LPK. Në simpoziume dhe konferenca shkencore kam dhënë kontributin tim me kumtesa. Me rastin e 80-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në simpoziumin e organizuar nga Instituti i Historisë në Prishtinë, kam marrë pjesë me kumtesën me titull 'Çështja shqiptare në 'Lahutën e Malësisë''. Në simpoziumin e organizuar nga nëndega e LPK-së në Gjermani më 1996 në Dyseldorf kam marrë pjesë me kumtesën 'Roli i arsimit në ngritjen e vetëdijes kombëtare të brezave në Kosovë'. Në vitin 2008 kam marrë pjesë në konferencën shkencore të organizuar nga Instituti i Historisë dhe Instituti Albanologjik, bashkë me Shoqatën e të Burgosurve politikë e të 'Kahet... e zhvillimeve politike pas demonstratave'. Në simpoziumin e organizuar në Deçan, në përvjetorin e rënies së heronjve afër Shtutgartit, me kumtesën: 'Publicistika e Jusuf Gërvallës'. Më 2011, në konferencën e organizuar me rastin e 30-vjetorit të demonstratave të vitit 1981, me kumtesën 'Komiteti i Deçanit - themelimi dhe veprimtaria para e gjatë demonstratave'. Në simpoziumin mbajtur në Zvicër me rastin e 80-vjetorit të lindjes së Adem Demaçit, me kumtesën mbi poezinë e Adem Demaçit, me titull 'Tung vargu im'. Në simpoziumin e organizuar nga Shoqëria 'Lëvizja', me kumtesën me titull 'Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kosovës...' dhe në simpoziumin e organizuar gjatë këtij viti në Shkup po nga shoqëria 'Lëvizja' me kumtesën 'Rreth disa mendimeve të Ukshin Hotit mbi ngjarjet e vitit 1981'. Punimin e magistraturës me titull 'Gjuha dhe stili në poezinë e Lagush Poradecit' dhe një vistër punimesh të tjera për të cilat nuk po zgjatëm më tutje. Në të ardhmen lexuesi juaj i respektuar patjetër se do të njihet edhe me punime të tjera në faqet e gazetës suaj.

(Fund)

Glllogjani brenda javës me të gjitha rrugët e asfaltuara

DEÇAN, 12 NËNTOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, të hënën ka inspektuar fillimin e punimeve për asfaltimin e rrugëve në Glllogjan të Deçanit. Këto punime të fazës së dytë të projektit për Glllogjanin kushtojnë rreth 650 mijë euro dhe pritet të përfundojnë brenda kësaj jave. Me përmbylljen e këtyre punimeve, Glllogjanit nuk i

mbetet asnjë rrugë e paasfaltuar. Me këtë rast, ministri Pal Lekaj ka uruar qytetarët e Glllogjanit, duke thënë se ky investim është i vonshëm për një vend me merita të mëdha për lirinë e vendit. Ndërsa kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka falënderuar ministrin Lekaj për mbështetjen e vazhdueshme që po i jep Deçanit dhe tërë komunave në vend.



Malisheva bëhet me inkubator të biznesit

MALISHEVË, 12 NËNTOR (ER) - Në vazhdim të mbështetjes për komunat e Kosovës, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka nënshkruar të hënën marrëveshje me kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, për nisjen e ndërtimit të inkubatorit të biznesit në këtë komunë. Ministri Shala ka thënë se qëllimi i kësaj marrëveshje është ndihma për komunat që bizneset të kenë kushte dhe mundësi më të mirë për ta zhvilluar veprimtarinë e

tyre. Shala ka thënë se ky nuk do të jetë projekti i vetëm në Komunën e Malishevës, por edhe në komunat e tjera do të ketë iniciativa të tilla. "Çdo ditë po punojmë që bizneset tona të kenë kushte dhe mundësi të operimit më të mira. Këto iniciativa do të vazhdojnë edhe në komunat e tjera. Jam i lumtur që sot nënshkrova një marrëveshje për nisjen e ndërtimit të Inkubatorit të Bizneseve në Komunën e Malishevës dhe se

shpejti do të nisim edhe punimet. Ky inkubator do të jetë një mundësi e mirë për të rinjtë e Kosovës që idetë e tyre t'i bëjnë realitet", ka thënë ministri Shala. Ndërsa kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka falënderuar Shalën dhe e ka quajtur lajm të mirë për bizneset nisjen e ndërtimit të inkubatorit. Kryetari Begaj është zotuar se do t'i kryejnë të gjitha detyrat që janë të përcaktuara me kontratë dhe të jetësohet sa më shpejt projekti.

Vetëvendosja në Prishtinë kërkon të ndalen ndërtimet pa leje

PRISHTINË, 12 NËNTOR (ER) - Zyrtarë të Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë kanë mbajtur të hënën një konferencë për medie në lidhje me qeverisjen në Komunën e Prishtinës. Sipas tyre, kjo komunë ka përmbysur për të keq frymën e madhe të ndryshimit, transparencën dhe bashkëpunimin me qytetarët. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje dhe ish-drejtori i Drejtorisë së Inspektionit, Salih Zyba, ka kërkuar të ndalen ndërtimet pa leje dhe të kthehet transparenca për lejet ndërtimore. "Ndryshimet e sjella me qeverisjen e mirë të Lëvizjes Vetëvendosje në Komunën e Prishtinës u vërejtën menjëherë. Sidomos, transparenca, guximi dhe veprimi për ta ndaluar degradimin e mëtutjeshëm urban të Prishtinës. Falë kësaj dhe shumë punëve të tjera, Lëvizja u dyfishua me vota, ndërsa në zgjedhjet lokale i fitoi edhe dy komuna të tjera dhe e rifitoi Prishtinën", ka thënë Zyba. Në këtë kontekst, ai ka theksuar edhe heqjen dorë të Shpend Ahmetit nga zbatimi i



programit, zotimeve para qytetarëve e votuesve të Lëvizjes dhe të tij personalisht, që i dhanë besimin për të qeverisur mirë. Ndërsa asambleti i Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, Abër Vokri, ka folur për sfidat dhe punët të cilat ishin bërë për ta

lehtësuar jetën e qytetarët dhe ndaluar të keqën në bashkëpunim të ngushtë me qytetarët, kurse në anën tjetër ka folur për degradimin e qeverisjes së Shpend Ahmetit në të gjitha drejtimit, madje duke lejuar edhe ndërtimet pa leje.

Komuna e Skenderajt vazhdon t'i mbështesë fermerët

SKENDERAJ, 12 NËNTOR (ER) - Komuna e Skenderajt, përkatesisht Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, është duke vazhduar mbështetjen për fermerët e kësaj komune me anë të subvencioneve të parapara për zhvillimin e bujqësisë. Në këtë kontekst, kjo drejtori ka hapur thirrjen për aplikim, duke ftuar të gjithë fermerët e interesuar të sektorit të pemëtarisë, të aplikojnë në kuadër të projektit "Mjete të punës". Pakoja

mbështetëse për fermerë përmban: pompë spërkatëse me bateri dhe panel solar, gërsërë për krasitje me dorëza vetëzgjatëse, gërsërë për krasitje të pemëve me prerëse dyanësore, si dhe vegla të tjera të punës. Drejtoria e Bujqësisë, e Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural ka caktuar edhe kriteret për aplikim, ndërkaq thirrja në kuadër të së cilës do të ndihmohen 30 fermerë do të jetë e hapur deri më 21 nëntor.



Njazi Thaçi: KEK-u është fuqia më e madhe ekonomike dhe sociale në Kosovë

PRISHTINË, 12 NËNTOR (ER) - Drejtori i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Njazi Thaçi, ka vizituar të hënën Termocentralin "Kosova B", me ç'rast ka thënë se është kënaqësi kur shih punëtorët duke punuar me shumë vullnet dhe në nivel të lartë të përgjegjësive. Ai ka bërë me dije se remontet janë gati dhe do të përfundohen më 15 nëntor

dhe do të jenë të gatshme për prodhim gjatë sezonit të dimrit. Thaçi ka vlerësuar se KEK-u është fuqia më e madhe ekonomike dhe sociale në Republikën e Kosovës. "Kjo atmosferë e punës është gjithmonë në Termocentralin 'Kosova B'. Nga hyrja në të gjitha repartet deri në dhomën e monitorimeve i gjithë stafi në krye të

detyrave dhe përgjegjësive. Për këtë frymë të mirë të punës dhe rezultatet e arritura meritoret janë të gjithë punëtorët, menaxhmenti dhe Luigj Imeri, drejtori i TC 'Kosova B'. Remontet janë gati dhe, siç është paraparë, do të përfundohen më 15. 11. 2018 dhe do të jenë të gatshme për prodhim gjatë sezonit të dimrit", ka thënë Thaçi.



Roli i ndërmarrësisë dhe inovacionit, faktor kyç në zhvillimin ekonomik

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Nën udhëheqjen e Innovation Center of Kosovo dhe në bashkëpunim me Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë, në Kuvendin e Kosovës është lansuar Java Globale e Ndërmarrësisë në Kosovë, gjatë së cilës në rreth 170 vende të botës zhvillohen aktivitete të ndryshme për ta ngritur vetëdijësimin mbi rolin e ndërmarrësisë dhe inovacionit.

Drejtori i Innovation Centre Kosovo (ICK), Uranik Begu, ka thënë se roli i ndërmarrësisë dhe inovacionit në Kosovë është faktor kyç dhe nxitës i zhvillimit të mëtejshëm ekonomik të vendit. Begu ka thënë se mbështetja e inova-



torëve dhe ndërmarrësve të rinj duhet të jetë një ndër objektivat kryesore të shtetit pasi këto gjenërojnë vende të reja të punës dhe e bëjnë Kosovën një shtet shembull të zhvillimit të ndërmarrësisë.

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka uruar fillimin e javës si një ndër aktivitetet kryesore të vitit, duke thënë se dija, inovacioni dhe ndër-

marrësia janë faktorët primarë për rininë e Kosovës për t'i zhvilluar idetë e tyre të bizneseve. Veseli ka thënë se zhvillimi i politikave dhe legjislacionit nga ana e Kuvendit synon ta lehtësojë të bërit biznes në vendin tonë, çfarë edhe rrjedhimisht rezultojnë në investime të huaja në vend. Ai ka theksuar se Kuvendi i Kosovës do të jetë në

përkrahje të iniciativave të tilla edhe në të ardhmen.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka pohuar se legjislacioni i të bërit biznes në Kosovë është më se i avancuar. Ai ka thënë se, pavarësisht prej zhvillimeve të bëra në legjislacion, bizneset vazhdojnë të hasin në sfida të shumta, duke përfshirë këtu mungesën e furnizimit të qëndrueshëm me energji si dhe barrierat burokratike, korrupsionin dhe mungesën e konkurrencës së duhur. Haradinaj ka thënë se Qeveria e Kosovës do ta vazhdojë mbështetjen e ndërmarrësve ashtu si deri tani, ku ka ofruar lehtësira për bizneset për heqjen e taksave nga lënda e parë dhe ofrimin e mbështetjes në nivel komunal.

E ngarkuara me punë në Ambasadën e ShBA-së në Kosovë, Colleen Hyland, e cilësoi Javën Globale të Ndërmarrësisë si një mundësi shumë të mirë të rritjes së vetëdijësimit mbi rolin e ndërmarrësisë në shoqërinë e Kosovës. Ajo ka thënë se nevojitet kurajë për të shndërruar një ide në një biznes të suksesshëm dhe se këto biznese kontribuojnë drejtpërdrejt në krijimin e vendeve të reja të punës.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se nuk ka vend më të mirë për lansimin e Javës Globale të Ndërmarrësisë në Kosovë, se Kuvendi i Republikës, se salla e takimeve ku marrin formë dhe jetë ligjet që lidhen me jetët tona dhe ku marrin drejtim përpjekjet për zhvillim.

Reçica nis konsultimet publike për konceptdokumentin e reformës pensionale

PRISHTINË, 12 NËNTOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, në një konferencë për media ka lansuar të hënën konsultimet publike për draftin fillestar të konceptdokumentit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe përfitimeve. Me këtë rast, ministri Reçica ka thënë se në kuadër të reformave të ndërmarrura në fusha të ndryshme, MPMS-ja ka ndërmarrë hapa edhe për reformimin e plotë të sistemit pensional, bazuar në vështirësitë

dhe problemet e evidentuara në analizat e ndërmarrura. Ai ka theksuar se sistemi aktual pensional i cili është i konstruktuar në tri shtylla nuk është i mirëfilltë pasi është ndërtuar duke krijuar skema pensionale ad hoc të cilat janë krijuar nga nevoja e kohës dhe, si të tilla, janë të paqëndrueshme.

Ministri Reçica ka treguar se reforma e ndërmarrë në fushën e pensioneve dhe përfitimeve parasheh hartimin e një projektligji unik për pensione, i cili do të përfshinte dhe trajtonte të gjitha të drejtat



për pensione, si dhe krijimin e Fondit për Sigurime Sociale, i har-

tuar me një ligj përkatës, në të cilin do të përcaktohej struktura organizative, forma menaxhuese, norma e kontributeve ose pensionale invalide. "Sistemi pensional në Kosovë do të ndërtohet në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe do të përbëhet nga katër shtylla në bazë të cilave konsiderojmë se do të vendoset një sistem i konsoliduar mirë, bazuar në standardet dhe praktikatat më të mira evropiane", ka deklaruar Reçica, duke shtuar se konceptdokumenti për reformën

në fushën e pensioneve, përpos krijimit të sistemit të mirëfilltë për gjeneratat e reja, parasheh edhe njohjen e stazhit të punës të punësuarve të cilët me dhunë janë larguar nga puna në periudhën e viteve 1990-1999. Reçica ka bërë thirrje për të gjitha palët e interesuara që, duke nisur nga 12 nëntori deri më 3 dhjetor, përfaqësojnë konsultimet publike, t'i paraqesin sugjerimet dhe komentet e tyre në lidhje me konceptdokumentin për pensionet dhe përfitimet.

KEDS-i: Rreth 400 familje të Lipjanit me rrjet të ri energjetik

Me projektin e quajtur TS 8 Lipjani, që ka implementuar KEDS-i, janë rreth 400 familje, kryesisht në pjesën jugore të qytetit të Lipjanit, të cilat tash kanë një gjendje shumë të mirë energjetike. Banorët e kësaj ane për çdo ditë kanë pasur probleme me rrymën. Rrjeti energjetik ka qenë i stërngruar dhe shumë i vjetër. Pas këtij investimi tash gjithçka është rregulluar, tensioni është stabil dhe me parametra standardë. Për implementimin e këtij projekti KEDS-u ka vendosur

dy trafostacione, njëra me kapacitet 1000 kVA, që është rinovuar dhe është bërë krejtësisht e re, një tjetër me fuqi prej 630 kVA. Gjithashtu, ka instaluar edhe 5000m kablo nëntokësore për tensionin e ulët dhe 3200m kablo nëntokësore për tensionin e mesëm dhe ka vendosur shtylla të reja të betonit dhe në disa vende ka vendosur edhe rrjet të ri ajror. Për këto ndryshime energjetike me shumë emocione flasin vetë banorët.

Nasibe Bajrami, e komunitetit

rom, tregon për rrezikun që kanë pasur para investimit dhe tani falënderon KEDS-in për punën që ka bërë. "Më shumë jena kanë pa rrymë se me rrymë. Shtyllën elektrike e kemi pas brenda në oborr dhe shpesh telat na binin në tokë, sidomos kur frynte era. Gjithë jena tut mos po ndodh ma e keqja. Tash KEDS-i e ka rregulluar dhe skema ma rrezik. Falënderojmë shumë kompaninë për punën që ka ba!", ka thënë Bajrami.

Edhe bizneset e vogla që operojnë në këto anë shprehen të kënaqura


me këto ndryshime.

Blerim Sylejmani, pronar i NPSH "Blerimi" që merret me gdhendjen e hekurit, disqeve të veturave etj., thotë se tani rryma është më e fortë dhe punën e kryejmë më shpejt. "Rryma ka qenë katastrofë, çdo 2-3 është dashur me u anku. Gjatë punës shpesh na u nalshin maqinat dhe puna nuk ecte. Tash është tepër mirë, rryma është e fortë dhe puna kryhet shpejt", është shprehur Sylejmani. Ky investim është edhe një zotim i KEDS-it për t'i përmbushur nevo-



jat dhe obligimet energjetike të konsumatorëve në tërë Kosovën, sipas dinamikës dhe planit të paraparë.

A JANË MË TË RREZIKSHËM SABOTUESIT E PAQES APO CUBAT E PRITËS?!



**Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA**

100 % në kundërshtim të korigjimit të kufijve: Hashim Thaçi, i rrethuar me pampersat që e shoqërojnë deri në çastin kur do ta thyejë qafën e që pastaj vetë këta do t'i vendosin lakun në fyt, nga Parisi dërgoi një porosi të fortë, se e paska përkrahjen 100 % të presidentit Tramp (mik i ngushtë i Behgjet Pacollit!!!) për "një marrëveshje të detyrueshme ligjore ndërkombëtare me Serbinë me të cilën do të sigurohej paqja në Ballkan, pas së cilës Serbia do ta njohë pavarësinë e Kosovës dhe se Kosova do të anëtarësohet në BE, NATO, Kombe të Bashkuara dhe në Organizatën Ndërkombëtare për Moral dhe Dinjitet - Kurvat dhe Kurvarët e Pavarur". Ky refren i stërpërsëritur është model gebelsian se, nëse një gënjeshtër plasohet disa herë në opinion, atëherë bëhet legjitime duke u shndërruar në diçka të vërtetë ose, më mirë ta them, përmes riciklimit të një gënjeshtre dhe mashtrimi ordiner, po bëhet pastrimi i saj ashtu si pastrohen paratë e pista. Realisht, siç e pati cilësuar Baca Adem, Hashimi është përlivan dhe lojtar i fortë përballë këtyre që nuk i njohin rregullat e lojës apo që e luajnë lojën hashimite. Në Paris, fillimisht një ish-shoqërues i sundimtarit të Kosovës, Bernard Kushner, e publikoi një libër, i dyti me radhë për Hashimin, e shprej se nuk do të jetë i fundit sepse personaliteti që po e shënon historinë e re të marrëdhënieve ndërkombëtare e meriton, jo disa libra, por edhe një enciklopedi të tërë. Shprej se Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, si truri i ikur i kombit, do ta nxjerrë nga harresa (e

përkohshme shprej) thënie gjeniale të Hashim Thaçit pas vizitës që i bëri, pas përfundimit të luftës AShAK-ut dhe pas së cilës në hyrje të Akademisë ishte një thënie gjeniale e Hashimit (po cila thënie e tij nuk është gjeniale!!!) e cila u hoq pas ndërhyrjes së dikujt e që u interpretua si reagim i shoqërisë civile e që nuk ishte fare e vërtetë. A ka më mjerim se kur e shihni transformimin e një ish-humanisti i cili, për një grusht parash të pista, shndërron në një lobist për diçka që edhe vetë e dinë se nuk është e vërtetë. Bernard Kushneri mbase nga moshja e ka harruar se çka ka thënë më parë për Hashim Thaçin, kurse tani e promovon si lider dhe si njeri i paqes!!! Tash, vetëm ditët janë në pyetje kur "Raketa" do ta botojë një libër për Kushnerin e që po e presim me padurim sikur edhe librat për Hashimin! Hashim Thaçi këtë po e shfrytëzon për mrekulli sepse lobistët e blerë me para të pista po e kryejnë punën për të. Po çka ia ndien Bernard Kushnerit, Petriçit, Arkanit, Sheshelit, Kurcit apo Begjës se çfarë do të bëhet me territorin e Kosovës kur nuk na ndien neve që po humbim territoret dhe ardhmëri në saje të tekeve të një grupi karrieristësh dhe profiterësh, të zhytur deri në thonj në punë të këqija dhe se këtë përpiqen ta shfrytëzojnë si rrip të sigurisë! Tash Hashim Thaçi në stilin e atyre që na kanë futur në burgje dhe kundër të cilëve edhe vetë e pati bërë luftën (qoftë edhe politike) po na etiketon se jemi kundër BE-së, Amerikës, kundër Mogerinit, kundër Trampit, kundër Kurcit dhe madje, për të na shkualifikuar përfundimisht, po na akuzon se jemi edhe kundër vetë Aleksandar Vuçiqit. Kohë të vështira janë këto. Dikush po thotë se këtë po e bën sepse në këtë mënyrë i shpëton Gjykatës Speciale e që unë nuk e besoj sepse mendoj pikërisht të kundërtën, sa më shumë e humbet përkrahjen në vendin tënd, aq më lehtë do të bëhesh klient i kësaj Gjykate dhe sa më shumë t'u nënshtrohesh

ndërkombëtarëve, fundin do ta kesh shumë më të keq. Ndërkombëtarët shkojnë dhe vijnë, kombi është i përjetshëm! Çfarë ka mbetur tash në planin politik nga takimet e Thaçit me baroneshën Ashton?! Asgjë hij! Po të mos ishte një kujtim emocional të raporteve Thaçi - Ashton, historia e botës do të mbetej e varfër. Kështu mbeti një tregim sikur i Romeos dhe Gjulietës, kësaj radhe, për fat të mirë, pa përfundim tragjik! Por gjithsesi me pasoja tragjike për shqiptarët dhe Kosovën! Cubat e pritës: Nga tregimet e odave, por edhe nga përvoja, kuptohet se prita është e keqe dhe shumë personalitete të shquara kombëtare dhe politike shqiptare kanë pësuar nga këto prita dhe rastin e Hasan Prishtinës e keni shembullin më të mirë për këtë. Prita nuk ka të bëjë me ndershmëri, moral, njerëzi; ajo nuk është virtyt, por ves shumë i keq. Këtë e kanë bërë të pabesët dhe të poshtrit! Kjo ishte sa i përket së kaluarës. Në kohën e zhvillimeve teknologjike prita ka tjetër kuptim dhe porosi. Sot prita përdoret për afirmim si mjet lobues, përkujtues dhe efektiv dhe efektiviteti i saj mbështetet në befasinë që ia bëni atij që ia bëni priten. Rasti më i freskët dhe më kuptimplotë ishte prita që ia bëri Behgjet Pacolli presidentit Tramp pasi doli nga WC-ja në ndërtesën ku mbahej takimi. E zuri gafil, ia shtriu dorën Trumpit e që pastaj u interpretua si një takim miqësor, konstruktiv me mikun personal dhe mikun e shqiptarëve, Donald Tramp, me të cilin u bisedua për zhvillimet në Kosovë, rajon dhe atë ndërkombëtare, ku Kosova luan rol të pazvëndësueshëm dhe se ku asnjë zhvillim nuk ndodh pa Kosovën dhe kundër interesave të saj. Po në këtë takim, presidentit Tramp iu dorëzua një ftesë për vizitë Marecit, Burojës dhe vendeve të tjera ekzotike të Karaibeve. Dhe presidenti Tramp me kënaqësi e pranoi këtë ftesë duke kërkuar që vizita të realizohet në kohën kur kushtet klimatike janë më të mira për shëndetin e tij dhe

shoqëruesve. Po në Paris, Hashim Thaçi pati takime me të gjithë ata që ishin në këtë organizim me rastin e 100-vjetorit të përfundimit të luftës së Parë Botërore ku vdiqën apo u vranë afërsisht 8 milionë ushtarë dhe 16-17 milionë civilë. Ishte menjëherë prapa Trampit që i ngjanë për nga inteligjenca dhe autoriteti ndërkombëtar si dhe fuqisë dhe pas Putinit që i ngjan për nga mënyra e të ushtruarit të demokracisë prej autokrati. Për qytetarët e Kosovës është me rëndësi se në ato takime pati përkrahje 100 % të Trampit dhe, sipas një automatizmi edhe të Putinit për marrëveshje me Serbinë, aq më parë që kjo marrëveshje edhe mund të bëhet sipas recetave të vet Putinit, ndryshe Vuçiqi nuk do të ishte aq i sigurt për këtë. Thaçi në këtë vizitë ishte i shoqëruar me prostituta politike dhe jopolitike. Nga aty dërgoi një porosi se është shumë i brengosur se Lista Serbe paska kaluar në opozitë, ndërkaq se nuk e ka të njëjtën brengosje se LDK-ja dhe LV-ja janë në opozitë. Thaçi shantazhin e ka modeluar në art, në art të shëmtuar, mirëpo i ndez gjithmonë kur e ka pisk, së paku deri më tani. Dikush që e shoqëron Thaçin çdo kohë dhe për të cilin Thaçi ka nevojë për shërbime orale, tha se takimi i Thaçit me presidentin Tramp ka zgjatur saktësisht 7 minuta, asnjë milisekond më shumë e as më pak. Tash, në raportimin e radhës, presim të na tregojë për potencën seksuale të presidentit përkatësisht se kur, sa dhe në cilat situata i çohet Hashimi i Hashimit! Apo se a janë më të zëshme, zërin e tonit dhe intensitetin e pordhave apo fendëve të Hashimit apo Behgjet Pacollit. Kjo është në interes të veçantë për Kosovën dhe qytetarët e saj, mos të them se paraqet interes jetik. Pasi e bashkuan Çamërinë, tash po e bashkojnë Luginën e Preshevës: Të shtunën e kaluar, ata që paraprakisht e kishin bashkuar Çamërinë, u bënë argatë të një manipulimi të pandershëm duke demonstruar goja për bashkimin e Luginës së Preshevës e që, pa dyshim, është

bërë sipas skenarit të korigjimit të kufijve ku Kosova e fiton Luginën e Preshevës pa dhënë as edhe një qime të prapanicës. Ofertë nga mashtruesit për ata që konsiderohen të jenë idiotë apo, siç thotë njëra ndër prostitutat e kombinuara politike dhe jopolitike, nuk kuptojnë asgjë nga bisedimet dhe raportit i forcave që i përcaktojnë këto bisedime, përkatësisht epilogun e "finales së madhe"! Nuk e kuptoj si është e mundur që këta të Preshevës dhe mashtruesit e emocioneve që ndërlihen me Çamërinë, aq lehtë po manipulohen! Vërtet, a po manipulohen apo janë pjesë aktive e mashtrimit dhe dëmit që po ia bëjnë kombit dhe vendit. Merreni me mend, afishuesit oralë dhe analë të korigjimit të kufijve, si ngushëllim po na ofrojnë konfederatën me Shqipërinë pasi ta kenë shkrirë një copë të madhe të Shqipërisë në Serbi! Çka të bëhet: Hashim Thaçi nuk e rrëzon Qeverinë derisa ta krijojë një qeveri rezervë, kondom qeveri, qeveri të Vishit, e cila do t'i miratojë dhe zbatojë vendimet që i merr. Kjo nuk duhet të pranohet. Lista Serbe është barkqitje e Vuçiqit në Kosovë dhe kurrë dhe asgjë nuk ka bërë për Kosovën e as që ka ndërmend ta bëjë. Mendoj se pikërisht pozita, me votat që i ka, së bashku me partitë opozitare, pas vlerësimit të drejtë, duhet të shkaktojë krizë qeveritare dhe rënie të qeverisë, duke e dërguar vendin në zgjedhje të parakohshme, jo në kohën kur i përshtatet Hashimit, Vuçiqit, Kurcit dhe Kushnerit, por kur ajo e vlerëson dhe se është i vetmi mjet për ta penguar në këtë aventurë të sinkronizuar të presidentit dhe prostitutave shoqëruese, politike dhe jopolitike. Nuk ka rrugë dhe mundësi tjetër nëse duam ta shpëtojmë Kosovën dhe Luginën e Preshevës. Apo, vetëm jam duke parë ëndrra dhe nuk po shoh më larg se hunda, për faktin se, sipas deklarimeve të një prostitute të kombinuar, kjo punë ka mbaruar! Nuk flitet për mundësinë, por flitet për një akt dhunimi të vullnetit të shumicës dhe i cili qenka i kryer!

Qëndron Kastrati u shpërndan kifle dhe qumësht nxënësve të Kamenicës

KAMENICË, 12 NËNTOR (ER) - Kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrati, bashkë me të parin e Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka realizuar premtimin e dhënë nxënësve të komunës që ai drejton. Qëndron Kastrati ka

shpërndarë të hënën kifle dhe qumësht për shkollarët e ciklit të ulët. "Gjatë vizitës së sotme bëra shumë shokë. Të gjithë të qeshur sepse vetëm me qejf mësohet. Jam frymëzuar pa masë prej atyre që po i hyjnë

shkollës për t'u hapur botës. Shkolla është vendi ku e shohim aktualitetin e së ardhmes. Ushqimi, ngrohja e veshmbathja janë kushtet minimale për një proces normal mësimor. Do të bëjmë gjithçka që shkollarët

tanë përgjatë kohës së mësimin ta kenë mendjen vetëm aty. Nëse do t'ia bëja vetë bilancin punës sime, suksesin në Kamenicë do ta kisha matur me suksesin në fushën e arsimit", ka thënë Kastrati.



ROLI I GRUAS NË LIRINË DHE PAVARËSINË E KOSOVËS



PhD Salihe SALIHU

Roli i gruas shqiptare për lirinë e Kosovës është shquar në çdo epokë të historisë sonë kur populli dhe trojet tona kanë qenë në rrezik. Lufta jonë për liri ishte rrugë e gjatë, por populli ynë nuk u pajtua me gjendjen e robërimit nga asnjë pushtues. Pushtimin e robërimit e luftoi edhe gruaja bashkë me burrin. Për heqjen e prangave të robërisë kontributi i gruas shqiptare shquhet në gjitha epokat, por kontributi më i freskët i gruas shqiptare është lufta për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Lufta për lirinë e Kosovës i ka rrënjët që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, kur u mposht robëria nga pushtuesit gjermanë, mirëpo Kosova u rikupua nga sllavët, kështu që kauza për lirinë e popullit shqiptar të Kosovës nuk u përmyll. Popullit shqiptar të Kosovës, për t'u çliruar nga ky ripushtim, iu nevojitën sakrificat të mëdha deri në vetëmohim. Në këto sakrificat gruaja shqiptare me përkushtim dhe vendosmëri u radhitë kra

krah me burrat që të luftojnë për liri e për pavarësinë e Kosovës. Mirëpo gruaja shqiptare edhe para se të shpërthente fronti i luftës së hapur ishte e angazhuar në grupe ilegale të asaj kohe, pa kursyer as jetën në mbështetje të lirisë e pavarësisë. Si ilustrim për angazhimin e femrës shqiptare kam intervistuar një grua që flet për kontributin e gruas. Gruaja e intervistuar është Advie Morina e cila ka lindur në burgun e Serbisë meqë nëna e saj Zyme Turjaka Morina ishte burgosur nga forcat e regjimit serb kur ajo ishte shtatzënë.

Zyme Turjaka Morina, si aktiviste e Frontit Nacional Demokratik Shqiptar, u burgos në vitin 1949. Forcat policore e marrin Zymën në shtëpi dhe me duar në brumë ia vendosin prangat. Për regjimin serb nuk mjaftonte vetëm prangosja dhe burgosja e Zyme Turjaka Morina, por ata kishin për qëllim edhe të futnin tmerr e panik në popullatën shqiptare. Me këtë qëllim, për ta demonstruar forcën e tyre pushtuese, ata përdornin strategji psikologjike për të mbjellë frikë e tmerr. Në rastin e Zyme Turjaka Morina, të cilën e prangosin në shtëpi dhe e marrin ashtu të lidhur, për të ecur në këmbë nëpër rrugët e qytetit të Pejës, deri te qelia e burgut. Zyma bashkë me burrin e saj Shani Morina, burgosen dhe maltretohen. Ndëshkimi ndaj këtij çifti ishte që t'i frikësojnë shqiptarët për t'u aktivizuar në luftë për çlirim. Ky

rast dëshmon se gruaja luftonte e sakrifikohej krahas burrit. Por, sa është numri i grave që u sakrifkuan për lirinë e Kosovës? Pra, me cilësi të sakrificës dhe të vetëmohimit u radhit gruaja shqiptare në organizata ilegale me qëllim që të japë kontributin e vet për lirinë e Kosovës.

Gruaja shqiptare mori pjesë edhe në protesta e demonstrata me kërkesën për lirinë e Kosovës. Burgjet e ish-federatës jugosllave ishin të mbushura edhe me femrat shqiptare nga të gjitha trojet shqiptare. Për këtë flasin edhe dëshmitë se kur u dënuan disa anëtare të grupit "Shote Galica" të qytetit Ferizajt, në vitin 1983, në mesin e tyre edhe unë e shumë të tjera, pasi u shqiptua dënimi me burg nuk kishte vende të lira nëpër burgjet e Kosovës dhe koha për ekzekutimin e dënimit u shty derisa të lirohet ndonjë vend nëpër burje.

E burgjet e Kosovës gjatë viteve të 1980 vërtet ishin të mbushura me bija shqiptare si Trendëlina Labënishtin, Ajshë Gjonbala, Hafide Topalli, Nazire Zogaj, Nazife Xhemajlin, Gjyle Krasniqin, Zyrafete Manaj, Havë Shala, Shahadije Neziri e shumë të tjera.

Edhe në diasporë gruaja shqiptare në mënyrë aktive mori pjesë në organizimin e tubimeve, protestave e demonstratave për ta sensibilizuar kauzën e popullit shqiptar. Dekadë pas dekadë këtë mision gruaja shqiptare e për-

bushi duke informuar shtetet e botës për gjendjen e aparteidit në Kosovë. Lufta e agjimit dhe e organizimit nuk ishte frontale, por ishte një front lufte i padukshëm, përplot rreziqe e sakrificat të panumërta e të pamatshme. Gruaja shqiptare u inkuadrua drejtpërdrejt edhe në frontin e luftës. Në jehonën e pushkëve të Luftës së UÇK-së u dëgjuan edhe krismat nga radhët e gruas shqiptare të cilat luftonin për lirinë e Kosovës. Ndër figurat më të njohura dhe që mund të paraqesin përfaqësim të dinjitetshëm për të gjitha luftëtarët e lirisë së Kosovës është heroina e kombit Xhevë Krasniqi Lladrovci. Mirëpo, gruaja shqiptare nuk u ndal vetëm për sakrificën për liri dhe pavarësi të Kosovës, por u angazhua edhe në luftën e popullit shqiptar në Maqedoni. Në këtë luftë mori pjesë edhe heroina ferizajase Hyrë Emmini (Mira) e cila më parë ishte ushtarë e UÇK-së e më pas u radhitë edhe në Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare, së bashku me bashkëluftëtarin Vjollca Fazliu. Pa mbështetjen e gruas shqiptare dhe aktivitetit të grave në këto procese, bazuar në faktet historike, nuk do të rritej dhe frymëzohej lufta për liri. Për ta fituar bindjen për këtë mjafton ta rikujtoni sakrificën e gruas te familja e komandantit legjendar Adem Jashari. Qëndresa e grave të familjes së Jasharëve, për të qenë krahe për krahe me burrat, dha jehonë anëmbanë botës dhe u

shndërrua në çelësin e artë, për ta argumentuar me fakte se armiku vranë jo vetëm burra, por edhe gra, fëmijë e pleq civilë.

Pikërisht nga sakrificat e grave, fëmijëve e pëlqeve u tronditi e tërë bota dhe lufta jonë fitoi përkrahje dhe mbështetje nga e gjithë bota demokratike. Mirëpo, aktet e vrasjes së grave, fëmijëve e pëlqeve, ishin faktorë mobilizues për gjithë shqiptarinë që filloi të kërkonte armë të vetëmbrohej. Kështu që lufta e UÇK-së mori mbështetje dhe u zgjerua e u fuqizua në gjithë Kosovën.

Me fuqizimin e luftës për liri kthim mbrapa nuk kishte për popullin shqiptar të Kosovës. Këtë përcaktim, për t'u sakrifkuar deri në vdekje, e kuptoi edhe faktori ndërkombëtar që i doli në ndihmë popullit tonë deri në çlirim.

Këto argumente flasin shkurt, por bindshëm se liria dhe pavarësia e Kosovës është e ujitur edhe me gjakun e sakrificën e gruas shqiptare dhe jam thellësisht e bindur se pa sakrificën e grave nuk do të mund ta fitonim lirinë. Pa angazhimin e gruas shqiptare, fillimisht për ta përkrahur UÇK-në e më pas edhe për t'u bërë pjesë e UÇK-së, nuk do të mundej të artikulohej e të përkrahej çështja e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Në luftën për lirinë e pavarësinë e Kosovës gruaja shqiptare dëshmoi heroizmin dhe u sakrifkua deri në vetëmohim. Prandaj, gratë janë pjesë e pandashme në të gjitha përpjekjet për liri dhe pavarësi të Kosovës.

Fillojnë ligjëratat në objektin e ri universitar të Universitetit 'Isa Boletini'

MITROVICË, 12 NËNTOR (ER) - Prej të hënës kanë filluar ligjëratat në objektin e ri të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë. Me këtë rast rektori Alush Musaj ka uruar studentët, mësimdhënësit dhe punëtorët e administratës, duke e vlerësuar këtë lajm të madh për të gjithë. Ai ka theksuar se kjo është një ditë e madhe jo vetëm për studentët dhe mësimdhënësit, mirëpo edhe për Mitrovicën dhe arsimin e lartë në Kosovë. "Është një kompleks madhështor, të cilin do ta gëzojnë studentët dhe mësimdhënësit tanë", ka thënë Musaj. Rektori ka falënderuar Parlamentin Studentor për angazhimin sa i përket transportit të inventarit nga objektet që janë shfrytëzuar deri më tash. "Studentët janë organizuar dhe kanë bërë një punë shumë të madhe në mënyrë që sa më parë të krijohen mundësi për sistemim në objektin e ri", ka thënë ai, duke kërkuar mirëkup-



tim për problemet që mund të dalin si pasojë e procedurave të zhvendosjes. Ai ka falënderuar edhe drejtuesit e ndërmarrjes "Trepça" për mundësitë e ofruara gjatë këtyre viteve për funksionimin e Universitetit "Isa Boletini".

Rektori Musaj ka paralajmëruar edhe organizimin e një ceremonie madhështore për përvënimin e kompleksit të ri uni-

versitar. Në kuadër të kompleksit universitar, që shtrihet në një hapësirë prej 17 hektarësh, janë ndërtuar objekte prej 30 mijë metrash katrorë që ofrojnë kushte komode për punë. Në kuadër të këtij projekti që realizohet nga Ministria e Administratës Publike planifikohet të ndërtohen edhe mensa, konvikti dhe hapësira rekreative-sportive.

62 lindje në QKUK vetëm në tri ditët e fundit

PRISHTINË, 12 NËNTOR (ER) - Në Klinikën e Gjinekologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) gjatë tri ditëve të fundit ka pasur 62 lindje. Sipas njoftimit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, të premten që lamë pas pati 28 lindje, të shtunën 12 dhe të dielën 22 lindje. "Në Klinikën e Gjinekologjisë në

QKUK gjatë tri ditëve të fundit ka pasur 62 lindje. Më 9 nëntor 28 lindje, 17 meshkuj, 11 femra, 10 gra janë bërë nëna për herë të parë. Më 10 nëntor: 12 lindje, 7 meshkuj, 5 femra, 5 gra janë bërë nëna për herë të parë. Më 11 nëntor 22 lindje, 11 femra dhe 11 meshkuj", është bërë me dije në njoftimin e QKUK-së.



REFLEKSIONE PËR LIBRIN "69 GRA" TË ARBËR AHMETAJT



Nga Dr. Irena GJONI

1. Hyrje

Libri 69 Gra i Arbër Ahmetajt, mund të konsiderohet si një dhuratë e çmuar e autorit jo vetëm për lexuesit besnikë të tij me rastin e 25-vjetorit të botimit nga libri i parë në vitin 1993, por edhe për çdo lexues të kultivuar e potencial që e adhuron mjeshhtërinë e rrëfimeve të shkurtra dhe që lehtësisht e gjen te ky libër. Është një botim i shtëpisë botuese prestigjioze Skanderbeg Books që në vite ka sjellë edhe librat e tjerë të Arbër Ahmetajt e ka rezultuar si një bashkëpunim shumë i suksesshëm. Në këtë vëllim janë përmbledhur 13 proza, që sipas autorit, vijnë si një Gërmadhë letrare: As tregime, as novela, aq më pak romane. Ky përcaktim, më rikthen në retrospektivë, pikërisht te fillesat letrare të Ahmetajt.

2. Shënjestra e rrugëtimit letrar

Fryma imponuese e letërsisë cilësore dhe ndikimi i saj, shpesh herë krijojnë një marrëdhënie sa magjike, aq edhe të çuditshme me shpirtin njerëzor. Më tepër sesa e pashpjegueshme në dukje, vihen në lojë "receptorë" të nënndërgjegjes, sepse vetëm prej tyre mund të perceptohet gjithçka që është gatitur brenda unit të autorit nën efektet e muzës dhe jo vetëm, që të bëjnë ta njohësh, ta duash e ta vlerësosh atë vepër. Është pikërisht ky libër, ky impakt e kjo lidhje, që të jep besueshmërinë dhe garancinë e mëpastajme për të marrë në duar pa frikë veprat e radhës së të njëjtit autor dhe të ndiesh se prej tij e ke të garantuar kënaqësinë estetike.

Dhe pikërisht, kështu ka qenë takimi im i parë me autorin Arbër Ahmetaj dhe me librin e tij Fletëhyrja për në varr në vitin e largët 1994 (një vit pas botimit). Ishte koha kur një brez studentësh dhe dashamirës të letrave, të etur për një letërsi cilësore dhe jashtë kornizave të letërsisë së mëparshme, ditëm ta mirëprisnim këtë autor dhe veprën e tij, fragmente të të cilit ishin prezantuar si risi në shtypin e kohës. Perceptimi i parë ishte i një libri "ndryshe", ku në vend të përcaktimit të llojit të prozës, vinte si nëntitull: Shënime për s'di se çfarë drejt veprë letrare. Jo vetëm për strukturimin e pazakontë, por edhe për idetë e pasura brenda lakonizmit, për fatet tragjike të personazheve, për rrugëtimit rrëqethës në ferrin shqiptar të dhënë përmes ferrit letrar të krijuar nga Ahmetaj, ku çdokush gjente sadopak nga shpirti i vet, Fletëhyrja për në varr u bë "fletëhyrja" e sigurt për një shteg të ri letrar të përfaqësuar nga Arbër Ahmetaj, ku gjurma e tij është

originale, unike dhe e pangatërrueshme. Kjo besueshmëri e garanci për të përcjellë vlerë, që u dha qysh me veprën e parë, do vijonte në gjithë rrugëtimit letrar të Arbër Ahmetajt, për të mbërritur deri te libri i fundit 69 Gra, që pata fatin ta lexoj në dorëshkrim.

3. 69 Gra si mjeshhtëri narracioni

Te libri 69 Gra, nënvizohen karakteristikat dhe veçoritë të prozës, që e veçojnë Arbër Ahmetajn nga prozatorët e tjerë. Talenti i tij i lindur, përvoja e akumuluar, perceptimi i realitetëve (në mënyrë të vullnetshme, apo të pavullnetshme), aftësia e trillimit, mpleksen së bashku duke u përthyer në prizmin e tij artistik për t'u shfaqur përtej këtij prizmi me pamjen fisnike e sharmante të prozave të mrekullueshme që na ofrohen te ky libër.

Pra kur lexuesi ta marrë në dorë këtë vepër, do vërejë se ajo çka lexon përmes gjuhës nuk është vetëm materializimi i mendimit, por edhe pafundësi e shpirtit njerëzor. Kjo është udha e krijimit te kjo vepër, apo e zbulimit të vetvetes, e krijimit e rikrijimit të univeseve te ndryshme (njerëzore a letrare), përmes narracionit plot ritëm të Arbër Ahmetajt.

Vihet re që secila prozë e librit 69 Gra, vjen unike edhe sipas dominantit tematik, edhe sipas dominantit strukturor me struktura kompozicionale të ndryshme, çka shënjojehet si një nga vlerat e këtij vëllimi. Kjo larushi në çdo aspekt, bën që këto proza të lexohen me një frymë, pa u kthyer në monotone e duke ruajtur magjinë e befasisë dhe dëshirën e zbulimit.

Aftësia e Arbër Ahmetajt është që përmes rrëfimit të tij, përmes teknikës së ndryshimit të strukturës së hapësirës dhe kohës, brenda 13 prozave të tij, të na çojë njëherësh sa me mungesë gravitacioni mbi qiejt e mjegullar mes Francës, Britanisë dhe Irlandës, aq i sigurt në tokë në kushedi sa destinacione; sa në pyllin e fëmijërisë e shtëpinë buzë rrugës që çonte për në zonën e thellë të Lekbibajve, në metropolin e botës; sa në Dublinin e Xhojsit, në Ballkanin tragjik; sa në kohën e Ciklit të Kreshnikëve, aq në modernitetin e kohës së tij; sa në ndjesitë e para erotike të një adoleshenti, në përvojat e një burri dhe ndikimit të grave në jetën e tij; sa në lirinë e ndrydhur brenda një kryqi të fshehur në gjë në një regjim të frikshëm, në hapësirat pa limit të mendimit të një qytetari të botës. Funkzioni estetik është mbi-zotërues te ky libër, por po kaq na shfaqet edhe funksioni njohës dhe kjo si një filozofi e autorit në zgjerimin e përmbajtjes së vizioneve për botën, por edhe si nevojë për zhvillimin e sistemeve të komunikimit, në këtë rast të komunikimit letrar. Autori sjell copëza bisedash për letërsinë, poetët, udhëtarët, siç


ndodh te proza Dublinasit. Si në një palimpsest vijnë vizionet e fëmijërisë, ku fati i tyre është përcaktuar e shënjuar nga rrethanat e kohës si te proza Gëzuar Krishtlindjet. Bisedat spontane me nënën dhe kapërcimet e natyrshme tematike sa të veshura me një tisi sinqeriteti fëmijëror dhe një urtie filozofike, duke u bërë pjesë të botëve të njëri-tjetrit, bartin atë lidhje të pakusht dhe të patjetërsueshme nënë - bir te proza Hëna kjo putanë kozmike. Notat e humorit duke ruajtur senset e masës, vijnë jo vetëm si një mjet për të shtensionuar situatat dramatike përgjatë narracionit, por edhe si një mënyrë këndvështrimi mbi to, si te prozat Fqinja jonë përvëluese, A mund të dashurosh kur vdes udhëheqësi etj.

4. Dimensioni shpirtëror e psikologjik në botëperceptimin e realitetit

Çdo prozë, është një botëpercep-

dashurive dhe jetëve njerëzore nën një regjim diktatorial etj. Te të gjitha bie në sy dimensionin e analizës psikologjike, veprimi i brendshëm i personazhit duke u perceptuar nga narratori, i cili në pjesën më të madhe rrefen në vetën e parë (me përjashtim vetëm në tri proza, nga një narrator i jashtëm). Gjithashtu, përshkrimi i ambienteve në këto struktura narrative, është i rëndësishëm dhe bëhet funksional duke shërbyer për të çuar më tej motivimin psikologjik të personazheve.

Njohja e vlerave etnopsikologjike të personazheve (shqiptarë, apo me etni të ndryshme), është shumë e dukshme te ky libër. Njëherësh jepen edhe të dhëna antropologjike që ndihmojnë në ndërtimin e lëndës tregimtare, apo në gjendjet e karakterizimit e personazheve, apo në situatat në të cilat ata vendosen brenda konteksteve të caktuara.



69 gratë që i dhanë titullin librit

Çdo prozë e këtij libri vjen me veçantinë dhe shkëlqimin e saj. Por si një sintezë e një pjese të rëndësishme të jetës së narrorit të këtij libri, vjen edhe proza që i ka dhënë titullin librit, 69 Gra. Duke i qëndruar besnikë mungesës së klasifikimit të llojeve nga ana e autorit që në hyrje të tij, te kjo prozë është akoma më e

vështirë të përcaktohet, nga mënyra se si e ka sjellë Arbër Ahmetaj imazhin e 69 grave. Mund t'i konsideroja si 69 bërthama narrative, të 69 tregimeve. Mund t'i konsideroja si 69 proza poetike me gjetje e detaje artistike shpeshherë të realizuara me një fjalor të përzgjedhur poetik. Mund t'i konsideroja si 69 personazhe gra të skicuara që me një rresht, deri në një paragraf, por jo më shumë. Ravijëzime portretesh të bëra në mënyrë shumë lakonike e të thuktë, por meritë e Arbër Ahmetajt është që edhe pse me kaq pak, mundet të japë individualitetin e originalitetin e pangatërrueshëm të secilës prej këtyre grave, si në imazh, si në historinë e intrigën që e identifikon.

Janë ravijëzime të bëra me shumë dashuri, pavarësisht nga rrethanat e "njohjes" me to. Ato lëvrijnë si nga hapësirat reale, hapësirat e legjendave, të historisë, të mitit, të fantazisë, të kombësive, racave e moshave të ndryshme. Erosi është këndvështrimi që herë bëhet i dukshëm, i drejtpërdrejtë dhe herë i fshehur apo i kamufluuar nën drita të tjera, por që nëpërmjet tij bëhet edhe vlerësimi në kompleksitetin i qenies femërore me gjithë virtytet e anët e errëta dhe karakteristikat individuale që bart secila. Vërehet diskursi vlerësues dhe admirues për të parë e shijuar "të bukurën" edhe përmes errësirës.

Kjo renditje fillon me Anna 0, ku Ahmetaj shkruan: Të mora nga një aromë pragpranvere e të bëra grua,

personazh në romanin tim. Tashmë ti ke mbetur e kurthuar mes faqeve të letrës dhe gishtave të lexuesve. Më fal, Anna! Se vetes nuk mund t'ia fal! Më pas vijnë gratë e tjera me individualitetin përkatës deri te numri 69 që nuk ka më një emër konkret si 68 të mëparshmet, por vjen si një përgjithësim: Të tjerat, ku Ahmetaj përfundon: Gratë e tjera të jetës time s'deshën të hynin në libër, por mbeten rebele, ashtu si ditën kur më thanë: JO! Ato nuk më deshën. Më kundërshtuan. Unë i kam dashur atëherë, i dua edhe sot. Në këtë renditje të 69 grave të Arbrit, duket sikur nuk ka ngelë model femëror pa u përfshirë dhe jo pa qëllim kjo prozë i dha edhe titullin librit.

Shoqërimi i ndonjë proze të librit me shënimin: Ngjarja e tregimit është reale me përjashtime të vogla, toponimet reale, inicialet e personazheve po realë, emra konkretë të personalitetëve të njohura nga fusha të ndryshme, kryesisht e letrave, vihen në funksion të dëshmisë së vërtetësisë së rrëfimit dhe besueshmërisë së këtij realiteti artistik, si për të krijuar një lidhje akoma më të ngushtë mes autorit e lexuesit. Në këtë linjë vjen edhe dedikimi i autorit në këtë libër si një mirënjohje: U kushtohet: Miqve të mi zviceranë që prej 21 vjetësh më janë gjendur me çiltësinë dhe miqësinë e tyre të çmuar, duke renditur shumë emra të miqve të tij që njëherësh janë edhe lexues të letërsisë së tij që për vlerat që posedon, prej vitesh i ka kapërcyer kufijtë me përkitimet në shumë gjuhë të huaja.

Pra, si përfundim, pas leximit të librit 69 Gra të Arbër Ahmetajt, më gëzon fakti që ky libër nuk mbyllet me përfundimin e leximit të faqes së fundit, por të mban ende të mbërthyer pas vetes me përjetimet mbi të. Me rrëfimin e përkohës dhe plot ritëm, me konceptimin modern të bërthamave narrative që në gjenezë, me një shumësi strukturash kompozicionale, me mjeshhtërinë e kapërcimeve shumë të natyrshme nga njëra situatë në tjetrën në vende e kohë të ndryshme, me galerinë e pasur të personazheve ku çdonjëra përvojë e përjetim nuk i ngjan tjetrit, me notat e humorit që të dhurojnë një ndjesi të këndshme buzagazi edhe në mes të tensionit dramatik, me fillin e dashurisë polisemantike që përshkon çdo ind të prozave, me ide të ngjeshura e me një larmi strukturash gjuhësore, stilesht etj., me këtë libër konfirmohet edhe një herë se Arbër Ahmetaj është një grave emrat më të rëndësishëm të letrave shqipe duke e çuar në një stad më tej e më të lartë prozën e shkurtër shqipe. Libri 69 Gra, nuk zhgënjn pritsmëritë e lexuesit i mësuar me një standard shumë të lartë që sjell proza e Arbër Ahmetajt, ndaj pa frikë mund t'ua sugjeroja të gjithë lexuesve që dinë ta shijojnë një letërsi cilësore, të cilët tashmë e konsiderojnë si një festë e ngjarje letrare ardhjen e çdo librit të ri të Arbër Ahmetajt.

E jashtëzakonshme

Britani, 10 vjet burg çiftit që i vuri foshnjës emrin Hitler

Një nënë dhe baba që e quajtën foshnjën e tyre Adolf Hitler u dënuan si anëtarë të një grupi neonazist. Adam Thomas, 22 vjeç dhe e dashura e tij, Claudia Patatas, 38 vjeçe, po përballen sot me një dënim prej 10 vjetësh burgim, pasi u dokumentua se ata shin pjesë e një grupi të ekstremit të djathtë. Gjatë kontrollit të banesës së çiftit në Oxfordshire u zbulua se banesa ishte e mbushur me memorandume naziste. Thomasi e pranoi se ishte admirues i Hitlerit, raporton "dailymail.co.uk".



BARSOLETA E DITËS



- A po e sheh, po lindin çdo vit e më pak foshnja, thotë njëra.
- Për këtë arsye na ka rënë mentaliteti, ia kthen tjetra.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

FOTO E DITES



Në Marok është mbajtur protestë masive kundër orës verore.

E rrallë

Kirurgu ngatërron veshkën me tumor dhe e heq

Një mjek ka ngatërruar veshkën me një tumor dhe e ka hequr nga trupi i pacientes. Ngjarja e pazakontë ka ndodhur në një spital në Florida në Wellington Regional Medical Center. Viktimë ishte një grua 51 vjeçe që në vitin 2016 i ishte nënshtruar ndërhyrjes kirurgjikale. Ajo së fund-



mi kishte kërkuar ndihmën e mjekëve për një dhimbje që iu shkaktua gjatë një aksidenti rru- gtor të ndodhur vite më parë.

 <p>DASHI Hëna në shenjë ju favorizon në çdo aspekt të jetës, por më shumë në atë sentimental. Jeni gjithë kohës në krahët e partnerit dhe ndiheni mjaft mirë.</p>	 <p>DEMI Sot jeni ju protagonistët e ditës në sajë të një marrëveshjeje mjaft të favorshme që keni arritur të mbyllni. Do të filloni të merrni përfitime shumë shpejt.</p>	 <p>BINJAKËT Do t'ju duhet të jepni prova që mund të përballoni një situatë stresi pa u alarmuar dhe pa ju zënë paniku. Më përpara nuk keni mundur ta superoni këtë gjë.</p>	 <p>GAFORRJA Çdo gjë që ka lidhje me ju sot do të jetë e ekzagjeruar. Do të doni shumë, do të luftoni shumë, do të mërzhiteni shumë dhe në çdo rast nuk do të ndaloni.</p>	 <p>LUANI Sot do të jeni kapriçioze për çdo gjë si në familje që do të kundërshtoni këdo edhe në punë që nuk do t'ju pëlqejë asgjë që do t'ju propozohet.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Edhe pse keni dyshime në një bisedë të bërë kohët e fundit, nuk do t'i shprehni ato pa u siguruar nëse qëndrojnë apo jo.</p>
 <p>PESHORJA Është periudha më e mirë për të folur për pushime dhe për udhëtime. Doni të vizitoni kultura të ndryshme dhe keni vendosur të merrni edhe miq me vete.</p>	 <p>AKREPI Xhelozit dhe debate në çdo çast me partnerin, tregojnë se duhet të vendosni një kufi ose duhet të lini gjithçka.</p>	 <p>SHIGJETARI Një ditë shumë e mirë sot për të gjithë ju që keni punuar fort për t'i arritur qëllimet tuaja. Më në fund pak dritë në fund të tunelit.</p>	 <p>BRICJAPI Disi në mënyrë të ndrojtur, por më shumë dashuri do të arrini t'i shprehni ndjenjat njeriut të zemrës. Kjo gjë do t'ju afrojë më shumë bashkë.</p>	 <p>UJORI Një ditë shumë e zakonshme dhe pa asnjë kulm të rëndësishëm. Gjithsesi ju dini të argëtoheni në çdo çast.</p>	 <p>PESHQIT Sot do të shkojë gjithçka siç e keni parashikuar, madje edhe më mirë. Jeni nën një aureolë optimizmi që do të bëjë që gjithçka të shkojë vaj.</p>

Nicki Minaj 'gjuan' aktorin e famshëm drejtpërdrejt



Gjatë ceremonisë së ndarjes së çmimeve "E! People's Choice Awards 2018", Nicki Minaj i kishte sytë te çmimi, por edhe te Michael B. Jordan. Derisa u shfaq në skenë për ta pranuar çmimin si 'artistja femër e vitit 2018', reperja nuk u vu fare në siklet duke shpalosur planet e mbrëmjes para pub-

likut. Duke falënderuar menaxherin e saj dhe fansat që e votuan, Minaj përfundoi fjalimin duke thumbuar aktorin. "Falënderim i veçantë për Donatella Versace që e bëri këtë kostum për mua dhe një falënderim për Michael B. Jordanin sepse ai do të ma zhveshë atë sonte", ka thënë ajo.



Brigitte Macron dhe Melania Trump, sfidë stilesh në Elize

Të dyja ato shoqëruan bashkëshortët në ceremoninë e 100-vjetorit të luftës së Parë Botërore. Pavarësisht prej temperaturave të ulëta në kryeqytetin francez, Brigitte Macron dhe Melania Trump zgjodhën kostume elegante dhe taka të larta.

Edhe pse vëmendja e publikut fokusohet te çfarë thonë Donald Trump dhe Emmanuel Macron, për zonjat e para sytë janë përqendruar tek ajo çfarë kanë veshur. E në këtë sfidë stilesh në Elize, mes dy zonjave të para, pakkush mund të thotë me siguri se kush fitoi.

Cheryl konfirmon ndryshimin në fytyrë

Cheryl ka konfirmuar se fytyra e saj ka ndryshuar, por krejt kjo ndodhi si rezultat i të qenit nënë. Këngëtarja 35-vjeçare lëshoi videon muzikore për këngën e re 'Love Made Me Do It' pas katër vjetësh, të premtën e kaluar. Fansat e pyetën për pamjen e saj, por Cheryl ka këmbëngulur që fytyra e saj ka ndryshuar pas lindjes së djalit të saj Bear.



Digjet edhe shtëpia e Miley Cyrusit pas zjarreve në Kaliforni



Edhe Miley Cyrus ka humbur shtëpinë e saj nga zjarret në Kaliforni. Këngëtarja 25-vjeçare konfirmoi lajmin përmes rrjetit social "Twitter", në natën e së dielës. "Të shkatërruar plotësisht nga zjarri që preki komunitetin tim. Unë jam një nga ata. Kafshët e mia dhe dashuria e jetës time janë të

sigurt dhe kjo është e gjitha që ka rëndësi tani. Shtëpia ime nuk ekziston më, por kujtimet e ndara me familjen dhe miqtë qëndrojnë të forta. Jam mirënjohëse për të gjitha që kam lënë. Dashuri dhe mirënjohje për zjarrfikësit dhe departamentin e policisë në LA", ka shkruar Miley.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

PONTE PRETA - CORITIBA

1

YORK - CHESTER

3+

HEREFORD - SOUTHPORT

2

Challandesi: Moskualifikimi është dështim, por jo fundi i botës

Kosova është në rrugë të mirë të kualifikohet në gjysmëfinale të Ligës së Kombeve, por trajneri Bernard Challandes vlerëson se do të ishte zhgënjim moskualifikimi, por jo edhe fundi i botës. "Dardanët" më 17 nëntor përballen me Maltën, kurse më 20 nëntor e presin Azerbajxhanin në stadiumin "Fadil Vokrri"



Mungon Celina, ftohet Demhasaj

Në grumbullimin e përfaqësueses së Kosovës do të mungojë Bersant Celina për shkak të lëndimit, kurse në vend të tij është ftuar Shkëlqim Demhasaj. "Celina ka problem pasi është lënduar në ndeshjen e së shtunës dhe sapo e kemi marrë raportin mjekësor të klubit të tij dhe është e qartë se ai nuk do të mund të luajë", ka thënë ai. Tekniku zviceran bëri me dije se pjesë e Kosovës do të jenë edhe Vojvoda, Kololli, Shala dhe Zhegrova. Ndërsa Demhasaj do t'i bashkohet përfaqësues sot (e martë).

EPOKA E RE
Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Bernard Challandes, në konferencë para ndeshjeve me Maltën dhe Azerbajxhanin, ka thënë se nuk dëshiron t'u bëjë presion lojtarëve për të arritur fitore. Trajneri zviceran dëshiron që Kosova të luajë mirë dhe në këtë mënyrë të vijë edhe deri te rezultati që dëshiron. "Po dëgjoj se po kërkohet gjithmonë fitore, por më duhet ta përsëris edhe një herë se për mua nuk është gjëja më e rëndësishme fitorja dhe si trajner nuk mund të mendoj vetëm për fitoren, përkatësisht vetëm për rezultatin. Për mua gjëja më e rëndësishme është se si të luajmë më mirë, veçmas pas ndeshjeve që e kemi pasur kundër Ishujve Faroc. Kjo nënkupton se presioni ndaj ekipit

nuk është të arrijmë fitore, por është të luajmë më mirë dhe ashtu siç kërkoj unë si ekip dhe të kemi mentalitet më të mirë. Dhe në këtë formë shpresoj të vijë edhe rezultati", ka thënë Challandes. Kosova është duke pasur rezultate të mira në Ligën e Kombeve dhe është afër të kualifikohet në gjysmëfinale, por trajneri Challandes ka thënë se, edhe nëse "Dardanët" nuk e arrijnë një gjë të tillë, nuk do të jetë fundi i botës. "Si trajner në situatën në të cilën ndodhemi aktualisht unë duhet të kem objektiva afatshkurtra dhe për ne aktualisht është e rëndësishme ta arrijmë kalimin në 'play-off' të Ligës së Kombeve. Po ashtu, nuk do të jetë fundi i botës nëse Kosova nuk do të kualifikohet. Jam këtu për ta vazhduar ndërtimin e një kombëtareje që është në proces. Kosova është duke e ndërtuar një shtëpi, Albert Bunjaku e ka vënë themelin e saj, kurse detyra

ime është të ndërtoj katin e parë. Normalisht se do të ishte zhgënjyese nëse nuk do të kualifikoheshim në gjysmëfinale të Ligës së Kombeve, mirëpo ne duhet të mendojmë për të ardhmen dhe ta vazhdojmë procesin e ndërtimit të ekipit dhe të shohim se çfarë do të sjellë e ardhmja", ka shtuar Challandes, i cili ka komentuar edhe vendimin e ish-kapitenit të Përfaqësueses U21, Ardian Ismajlit, që t'i bashkohet Kombëtares së Shqipërisë. "Në situatën tilla, nuk është vetëm lojtari që pyetet e duhet të bindet. Jemi në Kosovë. Këtu e dini

rëndësinë e familjes. Dhe, nganjëherë, agjenti dhe familja janë e njëjta gjë. Sepse në shumicën e rasteve janë familjarët që janë edhe agjentë të futbollistëve. Por, në rastin e Ardian Ismajlit nuk kam folur me familjen apo agjentin e tij. Ishte presidenti tashmë i ndjerë Fadil Vokrri që shkoi në Zagreb. Vokrri më kishte thënë se Ismajli ka vendosur të luajë për Kosovën. Në filozofinë time të punës është një parim që ne gjithmonë duhet ta mendojmë, duhet të ndihemi gjithmonë krenarë që jemi pjesë e Kosovës", ka deklaruar trajneri zviceran.



Feronikeli bën detyrën ndaj Ferizajt

DRENAS, 12 NËNTOR - Ka përfunduar ndeshja e fundit e xhiros së 15-të në IPKO Superligën e Kosovës në Futboll në mes të Feronikelit dhe Ferizajt. Kjo ndeshje është zhvilluar në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas. Fituese doli skuadra vendëse me rezultat 2-0. Sulmuesi Kastriot Rexha dhe Artur Magani shënuan golat e fitores në pjesën e parë të ndeshjes. Pas kësaj xhiroje Feronikeli vazhdon të jetë i dyti me 35 pikë, kurse Ferizaj renditet në pozitën e parafundit me 14 pikë.

Gashi, Prishtinës: Angazhohu maksimalisht në garat ndërkombëtare

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur sot në takim përfaqësuesit e Klubit të Basketbollit Z-Mobile Prishtina, pas suksesit historik të arritur për kualifikimin në mesin e 16 ekipeve më të mira në FIBA Europe Cup. "Bardhekaltrit" nga Prishtina kanë zhvilluar një ndeshje të shkëlqyer në Lituani, për ta shënuar fitoren e tretë në kuadër të Grupit E, triumf që kanë siguruar kryeqytetasit për herë të parë në histori të klubit, kalimin në fazën e dytë grupore në garën kryesore evropiane. Ministri Gashi i ka uruar basketbollistët dhe drejtuesit e klubit për suksesin e arritur. Ai vlerësoi



se me angazhim dhe vullnet mund të arrihet deri te sukcesi. "Si ministër dhe si ministri do të jemi bashkë me ju dhe do t'ju mbështesim në maksimum. Jemi në finalizim të ligjeve që do ta stimulojnë edhe më tej përkrahjen e sportit. Ju inkurajoj t'i shfrytëzoni këto përparësi ligjore", ka thënë Gashi, i cili ka kërkuar nga basketbollistët dhe

përfaqësuesit e klubit që në përfaqësimet ndërkombëtare ta japin maksimumin dhe ta prezantojnë Kosovën sa më me dinjitet. Ai u premtoi mbështetjen e plotë të MKRS-së edhe në të ardhmen. Ndërkaq basketbollistët dhe drejtuesit e Klubit Z-Mobile Prishtina e falënderuan ministrin Gashi për mikpritjen, urimin dhe gatishmërinë e treguar për ta mbështetur klubin e tyre. Ata premtojnë se në garat ndërkombëtare që do të marrin pjesë do të përfaqësojnë në mënyrën sa më të mirë të mundshme jo vetëm klubin dhe qytetin e tyre, por edhe Kosovën.

Sonte përballen Prishtina - Steaua

Sonte (e martë) nga ora 19:00 në Palestrën e Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, Z Mobile Prishtina është nikoqire e Steaua Bucurestit nga Rumania në kuadër të Grupit E të FIBA Europe Cup. Në ballafaqimin ndërmjet këtyre dy skuadrave të luajtura më 24 tetor në Bukuresht, fitore patën shënuar bardhekaltrit me shifrat 87:81. Z Mobile Prishtina tashmë e ka siguruar kualifikimin tutje në FIBA Europe Cup, duke zënë vend në mesin e 16 skuadrave që do t'i vazhdojnë garat në këtë kompeticion.

Panucci: Sadiku nuk na ka refuzuar, bën pjesë në planet tona

TIRANË, 12 NËNTOR - Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Christian Panucci, ka folur për refuzimin që i bëri Loret Sadiku grumbullimit me Kombëtaren e Shqipërisë.

Tekniku italian mohoi se Sadiku e ka refuzuar Shqipërinë, ani pse ka thënë se bën pjesë në planet e tij për të ardhmen. "E grumbullova, pastaj ai më shkroi një mesazh

dhe folëm. Ishte i lumtur për grumbullimin, por më tha se ka pasur disa probleme në të shkuarën dhe më kërkoi kohë, edhe për faktin se nuk ndihet në formë të plotë fizike. Nuk më

refuzoi, përkundrazi, ishte shumë i lumtur, por nuk ishte në formë të plotë fizike dhe vendosëm të mos vijë për momentin. Ai bën pjesë në planet tona", ka thënë Panucci.



Alvesi: Nuk pensionohem pa luajtur në Premierë Ligë

Paris, 12 nëntor - Mbrojtësi i PSG-së, Dani Alves, ka folur për "Telegraph", duke theksuar dëshirën e tij për të mos e mbyllur karrierën pa luajtur në Angli.

"Ideja e mbylljes së karrierës pa luajtur në Premierë Ligë nuk është e mundur. Në Angli luhet futboli më i pabesueshëm në botë. Mbi të gjitha, për respek-

tin që tifozët kanë për ne futbollistët, pastaj për pasionin dhe intensitetin në fushë. Do të ishte e përkryer ta kisha mundësinë për të luajtur në kampionatin

anglez. Do të ndodhë në një mënyrë, ose në një tjetër", ka thënë Alves, i cili ka luajtur edhe për Sevillën, Barcelonën dhe Juventusin.



Van Dijk: Shaqiri e bëri Liverpoolin më të fuqishëm

LIVERPOOL, 12 NËNTOR - Ylli i Liverpoolit, Virgil Van Dijk, e ka lavdëruar bashkëlojtarin e tij me origjinë shqiptare, Xherdan Shaqirin, për paraqitjet e këtij të fundit, duke thënë se ata janë të lumtur që e kanë shqiptarin në skuadër pasi ai ia ka shtuar cilësitë. Shaqiri e mori vëmendjen e medieve pas ndeshjes mes Liverpoolit dhe Fulhamit, që u zhvillua në "Anfield" dhe përfundoi me rezultat 2-0 për vendësit. Shaqiri e shënoi golin e dytë të ndeshjes me një volej nga brenda zonës së portierit. Mesfushori i Kombëtares së Zvicrës u transferua në Liverpool gjatë afatit kalimtar të verës nga Stoke City për 13.5 milionë euro, pasi që ish-klubi i tij ra nga Premierliga në Championship, nivelin e dytë të futbollit në Angli. Ndikimi i Shaqirit në "Anfield" është duke u rritur dalëngadalë. Kur u zëvendësua nga James Milner në minutën e 81-të të ndeshjes së djeshme, të gjithë tifozët u ngrehën në këmbë dhe e duartrokitën atë për shkak të paraqitjes së tij. "Ai është duke luajtur mirë dhe po punon shumë, si e gjitha pjesa tjetër e skuadrës. Kur atij po i ofrohet mundësia për të



luajtur, ai po e bën këtë gjë mjaft mirë. Ai arriti të shënojë, por ka qenë shumë i rëndësishëm në të gjitha ndeshjet e fundit dhe kjo është një gjë e mirë për ne", ka thënë Van Dijk. "Edhe lojtarët e tjerë janë të mirë në gjuajtje të lira.

Por, Shaqiri është një lojtar me cilësi të ndryshme dhe ai është gjithmonë shumë i rrezikshëm me këmbën e tij të majtë. Ai është duke luajtur shumë mirë dhe ne jemi të lumtur që e kemi", ka deklaruar mbrojtësi holandez.

Lakersat në sekondat e fundit e mposhtën Atlantën

LOS ANGELES, 12 NËNTOR - Fitorja e shtatë sezonale për Lakersin, që mundi në sekondat e fundit Atlantën me rezultatin 107-106, ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në fund. Një zhytje e LeBronit 15 sekonda nga fundi i dha fitoren ekipit kalifornian, me "King James", që realizoi 26 pikë, ndërsa për miqtë nuk mjaftuan 23 pikët e Princes dhe 21 të Bazemores për ta evituar humbjen. Vendimtar edhe Chandleri, që bëri një ndalje fantastike në sekondën e fundit. Humbet Bostoni, që u mund 100-94 nga Portlandi, ndeshje e dominuar nga vendësit, që në fund rrezikuan shumë. Lillardit me 19 pikë e 12 asistime ishte lider për Portlandin, duke i bërë të pavlefshme 27 pikët e Tatumit për Celticsin. Skuadra e Houstonit mundi 115-103 Indianan, sfidë e dominuar nga basketbollistët tek-sanë, që korrën suksesin e pestë sezonal. Më i miri në fushë ishte Hardeni me 40 pikë, mbështetur edhe nga Paul me 26. Vijon sezoni i



mirë i Milwaukeees, që mundi 121-114 Denverin, duke siguruar fitoren e 10 në kampionat. Të pestë titullarët e Bucksit realizuan mbi 10 pikë, madje 4 prej tyre arritën kuotën e 20 pikëve (Lopez 28). Ekipi i Charlotte, falë 24 pikëve të Walkerit dhe Parkerit, mundi 113-103 Detroitin jashtë fushës, ndërsa Orlando triumfoi 115-89 ndaj New Yorkut falë 17 pikëve të Knoxit.

REZULTATET

Detroit - Charlotte	103-113
Houston - Indiana	115-103
New York - Orlando	89-115
Denver - Milwaukee	114-121
Portland - Boston	100-94
Lakers - Atlanta	107-106

SHKURT

Hazardi: Jam i lumtur te Chelsea

Eden Hazardi ka thënë se është i lumtur në Chelsea pavarësisht prej thashethemeve për një largim të mundshëm të tij. Ylli belg gjatë verës kishte dhënë shenja se e ardhmja e tij mund të jetë larg "Stamford Bridge". "Për shtatë vjetët e fundit me Chelsea e kam shijuar çdo çast. Kur jam në fushë tentoj ta kënaqi vetën, pastaj tifozët që janë duke e shikuar ndeshjen. Për momentin ne jemi duke bërë një punë të mirë. Kështu që jam i lumtur momentalisht", ka thënë Hazardi.

Henry: PSG-ja ka më shumë kualitet

PSG-ja e mposhti Monacon me rezultat 4-0, ndërsa Thierry Henry ka thënë se kishte dallime në kualitet. "Ishte një diferencë mes kualitetit. Në fillimi gjërat filluan keq, pasi pësuam dy gola të shpejtë, ndërsa në fund ishte fitore e lehtë për PSG-n. Nuk kishte reagim nga ne, edhe pse lojtarët nuk e humbën fokusin. Me të gjitha lëndimet që kemi, ne arritëm të krijojmë shanse ndaj PSG-së", ka thënë Henry.

Leno, pasardhës i Neuerit në Bayern

Bayern Munchen mendon seriozisht për pasuesin e Manuel Neuerit për sezonin e ardhshëm. Drejtuesit "bavarez" janë të bindur se ka ardhur koha për rinovimin e portës dhe sytë e tyre janë përqendruar te Bernd Leno, të cilin duan ta rikthejnë në Bundesligë verën e ardhshme. "Gardiani" gjerman u ble për 25 milionë euro këtë vit nga Arsenalit dhe do të jetë shumë e vështirë që të privohet nga ish-lojtari i Bayer Leverkusinit, por "bavarezët" janë të bindur se vetëm një lojtar që e njeh mirë kampionatin mund ta pasojë Neuerin dhe Leno është i përzgjedhuri.

Juventusit, rekord historik në Serinë A

